

# RAPORTI I MONITORIMIT TË PROKURIMIT PUBLIK NË KOSOVË NDER ME TENDERË



---

© Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese dhe Internews Kosova, Prishtinë, Maj 2016.

Mendimet e shprehura në këtë dokument nuk paraqesin medoemos mendimet e donatorëve të Rrjetit Ballkanik të Gazetarisë Hulumtuese dhe të Internews Kosova, stafit, bashkëpunëtorëve apo Bordit të tyre. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet apo transmetohet në çfarëdo forme apo përmes çfarëdo mjeti pa leje paraprake. Kontaktoni me zyrën administrative të Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese apo Internews Kosova për kërkesa të tilla.

Botuar nga:

---



"Mensa e Studenteve" Kati i parë,  
Prishtinë 10000, Kosovë  
Website: [www.kosovo.birn.eu.com](http://www.kosovo.birn.eu.com)  
[www.internewskosova.org](http://www.internewskosova.org)  
Email: [kosova@birn.eu.com](mailto:kosova@birn.eu.com)  
[info@internewskosova.org](mailto:info@internewskosova.org)



---

**RAPORTI I MONITORIMIT TË  
PROKURIMIT PUBLIK NË KOSOVË  
NDER ME TENDERË**

---

**PRISHTINË  
QERSHOR 2016**

## “Kush rri nën dardha, han dardha”

Kajtaž Peci, pronar i kompanisë konkurrenente duke komentuar faktin që tenderi për transport të nxënësve në komunën e Mitrovicës në dëm të buxhetit të Kosovës u fitua nga babai i drejtorit të prokurimit në komunë

---

## “Nëse unë jap dorëheqje, OShP-në e merr lumi”.

Hysni Hoxha ish- kryetar i Organit Shqyrtues të Prokurimit i cili u detyrua të jap dorëheqje pas dy aktakuzave.

---

## “..nuk shoh asgjë të keqe që automjeti të servisohet në një servis të autorizuar. Shoh marri e budallëk që kjo të bëhet lajm..”

Isa Mustafa, lidhur me faktin që firma e djalit të tij fitoi tender për ta riparuar makinën e kryeministritë derisa Musfata është kryeministër.

---

## “Kjo zyrë po vazhdon me i kurdisë tenderët, me qëllim që të afërmit e zyrtarëve të marrin punë nga Komuna dhe kjo është arsyeja që investimet kapitale kanë cilësi të ulët.”

Sokol Bylykbashi, asambleist në komunën e Drenasit lidhur me tenderin e asfaltimit të rrugëve të cilën e mori kompania që është pronë e xhaxhait të Betim Berishës, drejtorit të urbanizimit të kësaj komune.

# PËRMBAJTA

HYRJE	06	PROJEKTET E MËDHA KAPITALE	44
METODOLOGJIA	09	ZYRA E KRYEMINISTRIT	46
KORNIZA LIGJORE	09	KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS	48
KATEGORITË E MONITORUARA	10	ZYRA E PRESIDENTIT	50
KOMUNAT	12	MUNGESA E VLERAVE TË PËRAFËRTA TË KONTRATAVE	51
INSTITUCIONET E PAVARURA	20	ÇMIMI MË I LARTË VS ÇMIMI MË I ULËT	55
NDËRMARRJET PUBLIKE	30	KORRUPSIONI NË PROKURIM PUBLIK	56
MINISTRITË	35	PËRFUNDIMET	63
AGJENCITË E PAVARURA	40	REKOMANDIMET	65

---

**AUTOR I RAPORTIT:**

Florina Ujupi dhe Albulena Sadiku

**KONTRIBUES:**

Rrahman Ramaj dhe Gresa Musliu

**REDAKTORË:**

Perparim Isufi dhe Ervin Qafmolla

---

# SHKURTESAT

<b>AKK</b> – Agjencia Kundër Korrupcionit	<b>ShKK</b> - Shërbimi Korrektues i Kosovës
<b>AQP</b> – Agjencia Qendrore e Prokurimit	<b>ShMF</b> - Shërbimet e Shëndetiti Mendor - Ferizaj
<b>BIRN</b> – Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese	<b>ShMGj</b> - Shërbimet e Shëndetit Mendor - Gjilan
<b>KRPP</b> – Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik	<b>ShMGjk</b> - Shërbimet e Shëndetit Mendor - Gjakovë
<b>KSK</b> - Këshilli i Sigurisë së Kosovës	<b>ShMM</b> - Shërbimet e Shëndetit Mendor - Mitrovicë
<b>MAP</b> - Ministria e Administratës Publike	<b>ShMP</b> - Shërbimet e Shëndetit Mendor - Pejë
<b>MAPL</b> - Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	<b>ShMP</b> - Shërbimet e Shëndetit Mendor - Prizren
<b>MASHT</b> - Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	<b>ShMPr</b> - Shërbimet e Shëndetit Mendor - Prishtinë
<b>MBPZhR</b> - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	<b>ShMSh</b> - Shërbimet e Shëndetit Mendor - Shtime
<b>MD</b> - Ministria e Diasporës	<b>SKGJK</b> - Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës
<b>MD</b> - Ministria e Drejtësisë	<b>SKQZ</b> - Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve
<b>MF</b> - Ministria e Financave	<b>SRGjk</b> - Spitali Regjional Gjakovë
<b>MFSK</b> - Ministria e Forcës së Sigurisë	<b>SRGjl</b> - Spitali Regjional Gjilan
<b>MI</b> - Ministria e Infrastrukturës	<b>SRM</b> - Spitali Regjional Mitrovicë
<b>MIE</b> - Ministria e Integriteteve Evropiane	<b>SRP</b> - Spitali Regjional Pejë
<b>MKK</b> - Ministria për Komunitete dhe Kthim	<b>SRPz</b> - Spitali Regjional Prizren
<b>MKRS</b> - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	<b>SV</b> - Spitali i Vushtrrisë
<b>MMPH</b> - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	<b>TRUST</b> - Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës
<b>MPB</b> - Ministria e Punëve të Brendshme	<b>UM</b> - Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini”
<b>MPJ</b> - Ministria e Punëve të Jashtme	<b>UP</b> - Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”
<b>MPMS</b> - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	<b>UP</b> - Universiteti Publik “Haxhi Zeka”-Pejë
<b>MSh</b> - Ministria e Shëndetësisë	<b>UPz</b> - Universiteti i Prizrenit
<b>MTI</b> - Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	<b>ZAMV</b> - Zyra Administrative e Mitrovicës Veriore
<b>MZhE</b> - Ministria e Zhvillimit Ekonomik	<b>ZAP</b> - Zyra e Auditorit të Përgjithshëm
<b>OSHP</b> - Organi Shqyrtues i Prokurimit	<b>ZKM</b> - Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës
<b>REC</b> - Qendra Rajonale për Mjedis për Evropën Qendrore dhe Lindore	<b>ZMF</b> - Zyra e Menaxhimit të Frekuencave
<b>RTK</b> - Radio Televizioni i Kosovës	<b>ZP</b> - Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës
<b>SF</b> - Spitali i Ferizajit	<b>ZRRE</b> - Zyra e Rregullatorit për Energji
<b>ShB</b> - Shërbimet e Burgjeve	<b>ZRRUM</b> - Zyra e Rregullatorit për Ujë dhe Mbeturina
<b>ShK</b> - Shërbimet e Kadastrës	

# PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Huluntuëse - BIRN ka filluar monitorimin e shpenzimeve përmes prokurimit publik që nga janari i vitit 2014, si pjesë e projektit të monitorimit të shërbimeve publike dhe shpenzimit të parasë publike.

Raporti i parë për vitin 2014, **“Arka e Favoreve”**, solli në pah parregullsitë që ndodhën gjatë dhënies së tenderëve që u raportuan dhe u konfirmuan me standardet ndëkombëtare të gazetarisë që zbatohen në produktet tona mediatike: Gazeta Jeta në Kosovë, Kallxo.com, Emisionin Jeta në Kosovë, Drejtësia në Kosovë dhe gazetën Prishtina Insight.

Monitorimi i prokurimit publik ka vazhduar edhe në vitin 2015, ndërsa ky raport është përmbledhje e të gjeturave vjetore për periudhën janar-dhjetor 2015të cilat i raportuam në mediat tona, por si shtesë, ky raport në vete përmban edhe:

- pjesën statistikore me përmbledhjen e të gjitha njoftimeve të publikuara në ueb faqen e KRPP-së,
- të gjeturat kryesore të dyshimeve për keqpërdorime të parasë publike
- raportimet nga seancat gjyqësore të monitoruara për keqpërdorime me tenderë, si dhe
- konkluzionet dhe rekomandimet për përmirësimin e dukurive negative të identifikuar në prokurimin publik.

Raporti **“Nder me Tender”** përmban gjetje thelbësore mbi identifikimin e parregullsive përmbajtësore, teknike, procedurale e administrative që ndodhin në prokurim publik, si dhe ofron rekomandime konkrete për marrjen e masave të nevojshme për përmirësimin e tyre.

Ky raport përmban të gjetura nga **monitorimi i 169 autoriteteve kontraktuese**, që janë

grupuar në këto kategori kryesore: Komunitat, Institucionet e Pavarura, Ndërmarrjet Publike, Ministritë, Agjencitë e Pavarura, Zyra e Kryeministrit, Kuvendi i Kosovës dhe Presidenca.

Një fenomen tjetër që po e gjejmë në monitorimin e kontratave në vitin 2015, e që është përsëritje nga viti 2014 janë opinionet e Agjencisë Anti Korrupsion të cilat nuk po mirren për bazë nga Institucionet buxhetore.

Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit Publik, apo më sakt pika 1.6 e obligon Agjencinë kundër Korrupsionit që të ofrojë opinione dhe të ndërmarrë të gjitha masat tjera ligjore me qëllim të parandalimit të konfliktit të interesit dhe të korrupsionit në tërësi.<sup>1</sup>

Agjencia Anti Korrupsion në vitin 2015 ka ofruar 65 opinione për institucionet buxhetore të cilat gjatë procedurave të tenderimit kanë shkelur ligjin e prokurimit publik duke rekomanduar me anulim të aktiviteteve të prokurimit.

Institucionet të cilat nuk janë deklaruar se kanë marrë për bazë opinionet e AKK-së dhe kanë anuluar aktivitetet e prokurimit janë të shumta si: Shërbimi Klinik Spitalor Universitar, Administrata Tatimore e Kosovës, Sekretariati Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Spitali Rajonal i Gjilanit, Spitali Rajonal i Mitrovicës, Organin Shqyrtues i Prokurimit.

Duke vazhduar me komunitat si ajo e Deçanit, Ferizajt, Graçanicës, Leposaviqit, Rahovecit, Lipjanit të cilat poashtu nuk janë deklaruar se AKK-ja ka pasur ndikim në anulimin e tenderave, përderisa Komuna e Zveçanit në dy raste ka injoruar opinionet e AKK-së. Për shkak Opinioneve të AKK-së nuk janë deklaruar se aktivitetet e prokurimit i kanë anuluar PTK-ja Trainkos-i, Infrakos-i, Ministria

<sup>1</sup> <http://www.akk-ks.orgwwwimi-i-korrupsionit-opinionet#indexmain>



e Drejtësisë, Ministria e Infrastrukturës, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Ministria e Administratës Publike, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Ministria e Forcës dhe Sigurisë, Ministria e Punëve të Brendshme, si dhe Agjencia Qendrore e Prokurimit, Agjencia për Ndihmë Juridike Falas dhe Agjencia për Produkteve Medicinale.

Praktika për transparencë në prokurimin publik edhe gjatë vitit 2015 na dëshmon se kjo fushë mbetet një problematikë serioze. Shkeljet e mëdha në fushën e prokurimit, që prej herës së fundit kur kemi bërë këtë raport, janë ato që kanë të bëjnë me **dy projekte kapitale** që në veti nënkuptojnë shfrytëzim më të madhin të resurseve publike.

Termocentrali “Kosova e Re” dhe projekti i qendrës së skijimit në Brezovicë, janë jashtë procedurave të prokurimit dhe nuk janë aspak transparente duke filluar që nga përzgjedhja e kompanive që do të operojnë me to.

Kosova e Re pritet të ndërtohet 30% nga kompania “Contur Global” dhe 70% me kredi nga Banka Botërore<sup>2</sup>, ndërsa Qendra Turistike në Brezovicë ishte dhënë me koncesion në shfrytëzim për 99 vjet.<sup>3</sup>, por më 17 qershor dështoi për shkak se “kompania franceze nuk i kishte përmbushur kushtet kontraktuale<sup>4</sup>”.

Gjithashtu, 2015 mund të shënohet një vit kur ka filluar akuza ndaj shtetit të Kosovës përmes një rasti të arbitrazhit që ka lidhje me prokurim të dëhstuar të viteve paraprake. Gazeta JnK zbuloi se buxheti i Kosovës mund të humbasë 180 deri në 500 milionë euro nga kompania gjermane “ACP Axos Kapital”, e cila në qershor 2015 ka paditur Postën dhe Telekomin e Kosovës (PTK) në Gjykatën e Arbitrazhit në Uashington për tenderin e vitit 2013, kur qeveria e asaj kohe kishte miratuar shitjen e 75% të aksioneve në VALA e Telekom.

2 Artikulli “Rryma e Shtrenjtë e ‘Kosovës së Re’ në Vitin 2022”, dhjetor 2015 <http://kallxo.com/rryma-e-shtrenjte-e-kosoves-se-re-ne-vitin-2022/>

3 Artikulli “Brezovica ‘rreshqet’ te francezët”, nëntor 2015 <http://kallxo.com/gjnk/brezovica-rreshqet-te-francezet-1/>

4 <http://kallxo.com/desh-ton-privatizimi-brezovices/>

Mungesën e transparencës lidhur me përgatitjet e qeverisë së Kosovës për t’u mbrojtur nga një humbje e tillë e pareve publike në arbitrazh janë duke ushqyer dyshimet e disa të cilët po tërheqin vëmendjen që individë të caktuar në pushtet janë të interesuar që Kosova ta humbë këtë rast në arbitrazh në mënyrë që, ata që ashtu-kështu e inicuan privatizimin e PTK-së pa kaluar në procedura të duhura parlamentare për blerjen e një ndërmarrjeje kaq të rëndësishme publike, të përfitojnë rryshfet nga kompenzimi sa më i madh që do paguajë qeveria e Kosovës për AXOS, kompani me bazë në ishujt Kejman.

Raporti ynë gjithashtu ka matur se sa prej institucioneve të Kosovës njoftojnë me kohë, sipas ligjit për kontrata publike, dhe ka konstatuar që **mbi 90% e institucioneve të Kosovës nuk i publikojnë njoftimin e kontratave me vlera të mëdha me kohë** për shkak që:

- nuk janë të gatshme për transparencë,
- nuk kanë planifikim të mirëfilltë për shpenzime dhe investime dhe
- fshehin të dhëna nga operatorët ekonomikë për të favoziuar operatorë të caktuar.

Fenomeni i **shpërblimit me tenderë për shoqërinë dhe familjarët e politikanëve** në pushtet, apo të zyrtarëve të prokurimit është një trend i cili ka vazhduar edhe gjatë vitit 2015.

Gjatë vitit 2015 tenderin më të përfolur **e kanë fituar djemtë e Kryeministrit Isa Mustafa**, Arben dhe Besnik Mustafa, në Zyrën e Kryeministrit me procedura të kuotimit për rregullimin e automjetit, e që u publikua pasi që u nënshkrua kontrata sepse ligji ashtu e lejon, që te kuotimet nuk bëhet thirrje për tender.

Një tjetër tender që futi në telashe komunën e Mitrovicës me KRPP-në, ishte kur Drejtori i Prokurimit në këtë komunë, Besnik Beka, **shpërbleu kompaninë e babait dhe xhaxhallarëve** të tij për transportimin e nxënësve edhe pse kompania e kishte çmimin më të lartë. Që kjo të mos bëhej publike, komuna nuk e dërgoi fare dosjen e tenderit për publikim në KRPP, duke u arsyetuar se po

atë ditë KRPP-ja ka pasur probleme teknike me uebfaqen e saj.

Komuna e Skenderajt u furnizua me naftë nga **asamblisti partisë në pushtet**, PDK-së, Musa Hajdari me të cilin komuna lidhi kontratë prej 250 mijë euro për furnizim me derivate nga kompania "Alfa Trade" ku Hajdari është bashkëpronar.

Një tjetër komunë, ajo e Drenasit, vendosi që asfaltin **t'ia besojë xhaxhait të drejtorit të urbanizimit** Betim Berishës, duke e shpërblyer me tender kompaninë e Demir Berishës "Trasing Gropup" me 1.8 milion euro.

Pa skandale nuk kaloi as UP-ja e cila në kohën sa ishte **rektor Mujë Rugova lidhi një kontratë të negociuar** pa publikim prej 3.3 milionë euro për libra shkencorë për shumicën e fakulteteve, të cilat i shfrytëzoi vetëm Fakulteti i Mjekësisë, ndërkohë që fakultetet tjera nuk kishin dijeni për këto libra.

"Trepça" me seli në Zveçan lidhi kontratë me kompaninë rumune "Mineco", udhëheqësit e të cilës **akuzohen për korrupsion** në Rumani. Vlera e kontratës varion nga 15 deri në 20 milionë euro, ndërsa kontrata iu dha kësaj kompanie me një kusht që ajo t'i tërheqë akuzat e mëhershme që i ka bërë ndaj "Trepçës" në gjykatat e Kosovës.

Prokurimi publik karakterizohet aq shumë nga korrupsioni, sa që BE ka vendosur depolitizimin e OShP-së si kusht për liberalizimin e vizave ndaj Kosovës.

Kjo rezultoi me dorëheqjen e Hysni Hoxhës, kryetar i OShP-së, **i cili ka tri aktakuza të ngritura ndaj tij**, dhe që kishte deklaruar për Gazetën Jeta në Kosovë që këto nuk ishin arsyet e dorëheqjes së tij por lodhja nga mos-emërimi i dy anëtarëve të bordit për dy vite. Mosplotësimi i bordit të OShP-së shihet të jetë njëri prej regreseve të shënuara edhe në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2015.

I njeiti raport në fushën e prokurimit publik si pozitive e ka parë vetëm prokurimin e

centralizuar. Agjencia Qendrore e Prokurimit ka arritur t'i kontrakttojë derivatet për 80 Autoritete Kontraktuese, por kompania "HIB Petrol" u shpërblye me tender prej 12.3 milionë euro, **edhe pse ndaj saj janë ngritur dy aktakuza**, njëra e inicuar nga Policia e Kosovës dhe tjetra nga komuna e Prishtinës.

Një tjetër problem që ka Kosova e që prek direkt fushën e prokurimit është konkurrenca jo e pastër në treg. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës që ka për detyrë luftimin e monopolit **ka 4 vite që është jofunksional**, pasi ky mekanizëm shtetëror tashmë nuk ka asnjë anëtar të bordit. Është përgjegjësi e klasës politike t'i caktojë anëtarët e bordit në këtë autoritet të konkurrencës, andaj mos-caktimi i tyre ngrit dyshimin që njerëzit e politikës në Kosovë kanë interes prej firmave që e mbajnë monopolin në shërbime të caktuara. Andaj edhe kompania HIB Petrol është e pa konkurrencë në marrjen e 80 përqind të tenderëve publikë.

Raporti i Progresit për vitin 2015 nuk ndryshon shumë nga ai i vitit 2014 ku vazhdimisht potencohet se korrupsioni dhe planifikimi i dobët në fushën e prokurimit ende mbeten sfidë e madhe dhe ku kërkohet zbatim efektiv i kontratave. Më specifikisht aty thuhet se "sistemi jotransparent i organeve të drejtësisë në fushën e prokurimit" është pengesë e madhe.

"Zbatimi efektiv është një sfidë e madhe, kryesisht për shkak të planifikimit të dobët dhe korrupsionit. Pothuajse 30% e njoftimeve të kontratës janë anuluar, duke treguar për një nevojë për t'u përmirësuar planifikimi i prokurimit, rreziqet dhe mangësitë ekzistojnë në të gjitha fazat e prokurimit publik. Procedurat e prokurimit dhe menaxhimit të kontratave janë në vend, por kapaciteti i zbatimit duhet të përforcohet," thuhet në raport.<sup>5</sup>

Rekomandimet konkrete nga raporti "Nder për Tender" BIRN-isynon t'i drejtojë tek institucionet përkatëse vendim-marrëse,

<sup>5</sup> Komisioni Evropian. Raporti i Progresit për Kosovë 10 nëntor 2015 [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2015/20151110\\_report\\_kosovo.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2015/20151110_report_kosovo.pdf)

në mënyrë që procesi i prokurimit publik të realizohet në mënyrë ligjore duke ofruar efikasitet dhe efektivitet në shpenzimin e parasë publike.

Të gjeturat e BIRN-it paralajmërojnë nevojën për depolitizimin dhe funksionalizimin e mirëfilltë të gjykatës së tenderëve OSHP-

së, për ngritjen e kapaciteteve njerëzore, trajnimin adekuat të zyrtarëve të prokurimit si dhe nevojën për prokurim të centralizuar pa e dëmtuar konkurrencën e lirë.

## II. METODOLOGJIA DHE KORNIZA LIGJORE

Ashtu sikur që ka bërë në raportin e vitit 2014 “Arka e Favoreve”<sup>6</sup>, BIRN edhe në vitin 2015 ka analizuar klasifikimet e kontratave publike nga Autoritetet Kontraktuese duke krahasuar numrin dhe vlerat e kontratave nga viti i kaluar.

Krahasimi i të dhënave nga viti në vit ka pasur për qëllim të tregojë gjendjen e prokurimit publik në Kosovë, a ka pasur përmirësime në këtë fushë, a është rritur transparencja, si janë zhvilluar procedurat, si qëndron gjendja e shpenzimit të buxhetit krahasuar me vitin paraprak.

Gjatë kësaj periudhe, BIRN ka monitoruar 169 autoritete kontraktuese të cilat kanë zhvilluar aktivitetete të prokurimit publik.

Monitorimi ka pasur shtrirje në të dyja nivelet e qeverisjes, konkretisht në nivelin lokal duke përfshirë **38 komuna dhe atë qendror, i cili përfshin 19 ministri, 62 institucione të pavarura, 33 ndërmarrje publike, 14 agjenci të pavaruara, Zyrën e Kryeministrit, Kuvendin e Kosovës dhe Zyrën e Presidentit.**

Përveç kësaj, monitorimi ynë i prokurimit publik gjithashtu është bazuar në analizën e këtyre burimeve:

- a) legjislacionit i cili ishte në fuqi deri në janar 2016

- b) të dhënat nga raportet dhe studimet tjera të publikuara në këtë fushë nga organizata vendore e ndërkombëtare.

- c) artikujt e dokumente të publikuara në media që janë ndërlidhur me rastet e përcjella gjatë kësaj periudhe raportuese (janar-dhjetor 2015).

Bazuar në Ligjin për Prokurim Publik, kontratat publike grupohen sipas vlerave të tyre, duke u kategorizuar kështu në kontrata të mëdha, të mesme dhe të vogla.<sup>7</sup>

Kontrata me vlerë të madhe konsiderohen ato kontrata të furnizimit tëshërbimeve vlera e të cilave është e barabartë apo më e madhe se 125 mijë euro, kurse te punët vlera e të cilave është e barabartë apo më e madhe se 500 mijë euro.<sup>8</sup>

Ndërkaq kontratë me vlerë të mesme konsiderohet kontrata e furnizimit ose shërbimeve vlera e parashikuar e të cilave është e barabartë ose më e madhe se 10 mijë euro por më e vogël 125 mijë euro.

Kurse për punë vlera e parashikuar është e barabartë ose më e madhe se 10 mijë euro, por më e vogël 500 mijë euro.<sup>9</sup>

6 Raporti i prokurimit 2014 “Arka e Favoreve”, shkurt 2015 [http://jetanekosove.com/repository/docs/BIRN-shq-ip\\_350845.pdf](http://jetanekosove.com/repository/docs/BIRN-shq-ip_350845.pdf)

7 Ligji për Prokurimin Publik në Kosovë.29 Gusht 2011. Fq. 24-25. <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Ligji%20per%20prokurimin%20publik.pdf>

8 Neni 19.1 i Ligjit për Prokurim Publik

9 Neni 19.2 i Ligjit për Prokurim Publik

Ndërkaq kontrata me vlerë të vogël konsiderohet çdo kontratë publike vlera e parashikuar e së cilës është e barabartë ose më e madhe se 1 mijë euro, por më e vogël se 10 mijë euro.<sup>10</sup>

Për qëllim të shqyrtimit të kontratave publike, BIRN ka përcjellë njoftimet e shpallura nga autoritetet kontraktuese në faqen zyrtare të KRPP-së, sipas kategorive të paraqitura në viim:

**Tabela 1. Njoftimet e publikuara të prokurimit 01 janar-31 dhjetor 2015**

	Njoftim Kontrate	Njoftim per dhenie te kontrates	Njoftim anulimi	Njoftim paraprak	Njoftim mbi rezultatin e konkursit	Njoftim mbi konkurs Projektimin	Njoftim konkurs projektimi - Hapja e Ofertave financiare	Njoftim i anulimit te kontrates	Njoftim per informata shtese ose permiresim i gabimit	TOTALI
Komunat	2243	3023	539	7	9	10	2	33	49	5915
Institucionet e pavarura	1281	1262	584	7	2	1	0	27	27	3191
Ndermarrjet Publike	1116	1096	395	9	2	4	0	29	30	2681
Ministrite	538	637	244	4	1	5	4	26	27	1486
Agjencit e Pavarura	103	203	31	11	0	0	0	6	10	364
Zyra e Kryeministrit	9	22	2	0	0	0	0	0	0	33
Kuvendi i Kosoves	44	27	33	0	0	0	0	0	0	104
Zyra e Presidences	7	34	2	0	0	0	0	0	0	43
TOTAL	5341	6304	1830	38	14	20	6	121	143	

<sup>10</sup> Neni 19.3 i Ligjit për Prokurim Publik

Ky Raport i Monitorimit të Prokurimit është hartuar brenda kornizave ligjore të vendosura nga sistemi legjislativ i prokurimit publik në Kosovë bazuar në Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042 i cili ishte në fuqi deri më 20 janar 2016.

Procesi i prokurimit publik në Kosovë zhvillohet në kuadër të legjislacionit primar, përkatësisht Ligjit për Prokurimin Publik; dhe atë sekondar që përfshin akte nënligjore siç janë udhëzimet dhe rregulloret e brendshme të punës të akterëve relevantë si Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, Agjencia Qendrore e Prokurimit dhe Organi Shqyrtues i Prokurimit.

Nga 22 janari 2016 ka hyrë në fuqi ligji i ri për prokurimit publik, Autoritet Kontraktuese nga kjo datë janë të obliguara që proceduarat e prokurimit t'i zhvillojnë me ligjin e ri. Kurse sa i përket legjislacionit sekondar, aty përfshihen aktet nënligjore si në vijim:

- Udhëzuesi operativ për prokurimin publik të KRPP<sup>11</sup>
- Rregullorja e punës së Agjencisë Qendrore të Prokurimit<sup>12</sup>
- Rregullorja e punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit<sup>13</sup>

## III. (MOS)TRANSPARENCA NË PUBLIKIME TË NJOFTIMEVE

Një nga kriteret e vlerësimit të transparencës së institucioneve në fushën e prokurimit publik është edhe njoftimi paraprak rreth kontratave.

Autoritet Kontraktuese pas planifikimit final të buxhetit, tenderët me vlera të mëdha deri në 500 mijë euro të cilat do të tenderohet gjatë një viti fiskal apo 12 muajve duhet t'i publikojnë me një formular standard të njoftimi paraprak që gjenedet në ueb faqen e KRPP-së.

Njoftimi paraprak përgatitet nga zyrtari i prokurimit dhe publikohet në fillim të vitit fiskal, për furnizimet, shërbimet dhe projektet me vlera të mëdha.

Sa i përket njoftimeve paraprake sipas KRPP-së ligji për prokurim publik thotë:

“Kur një autoritet kontraktues ka për qëllim dhënien, gjatë periudhës së ardhshme 12 mujore të një ose më shumë **kontratave të furnizimit, të shërbimeve apo të punëve, që vetëm ose bashkë, kanë një vlerë të parashikuar 500 mijë Euro**, lidhur me secilën

kategori të përmendur autoriteti kontraktues do të përgatisë njoftimin paraprak.”

Në anën tjetër, sipas Udhëzuesit Operativ Për Prokurim Publik, neni 5, njoftimi paraprak ndihmon në çështje si:

- Ndhimesë në transparencë dhe është në të mirë të operatorëve ekonomikë;
- Mundëson AK të shkurtojë afatet minimale kohore të tenderimit për kontratat e mëdha nga 40 ditë në 24 ditë;
- Njoftimi Paraprak mund të zëvendësojë Njoftimin për Kontratë në procedurë të kufizuar ose të negociuar pas publikimit të Njoftimit për Kontratë;

11 KRPP “Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik” <http://krpp.rks-gov.net/krpp/PageFiles/File/draftLS/Shqip/Udhezues%20Operativ%20per%20Prokurimi%20Publik.docx>

12 Agjencia Qendrore për Prokurim <https://aqp.rks-gov.net/sq/organizimi>

13 Organi Shqyrtues i Prokurimit “Rregullorja e punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit publik të Kosovës” [http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/Rregullorja\\_ËEB\\_1.pdf](http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/Rregullorja_ËEB_1.pdf)

Nga tabela e lartëshënuar, për të gjitha institucionet janë publikuar vetëm 38 njoftime paraprake, pavarësisht se janë 416 njoftime për kontrata me vlera të mëdha me 260.7 milionë euro në të gjitha nivelet.

Kjo është indikacion i tri shprehive që i konstaton raporti ynë e ato janë se mbi 90% e institucioneve të Kosovës vendosin të mos

njoftojnë me kohë për kontrata publike për shkak që:

- nuk janë të gatshme për transparencë,
- nuk kanë planifikim të mirëfilltë për shpenzime dhe investime dhe
- fshehin të dhëna nga operatorët ekonomikë për të favorizuar operatorë të caktuar.

## IV. KOMUNAT

Analizimi i tenderëve në të gjitha komunat është bërë përmes shqyrtimit të materialeve të prokurimit publik, të cilat janë të publikuara në uebfaqen e KRPP-së.

Metodologjia e monitorimit dhe analizimit të tenderëve ka ndjekur disa nivele, duke filluar që nga procesi i njoftimit për kontratë - nëpërmjet të cilëve u bëhet thirrje operatorëve ekonomikë për të konkurruar në tender, dhënia

e tenderëve, anulimi i tyre para shpalljes së njoftimit për dhënie të kontratës, e deri të anulimi nga OShP pas njoftimit për dhënie të kontratës.

- Më poshtë janë paraqitur të gjitha njoftimet e publikuara në uebfaqen e KRPP-së për periudhën janar-dhjetor 2015, për nivelin lokal

	Numri
Njoftim Kontrate	2,243 38%
Njoftim per dhenie te kontrates	3,025 51%
Njoftim anulimi	539 9%
Njoftim paraprak	7 0.12%
Njoftim mbi rezultatin e konkursit	9 0.15%
Njoftim mbi konkurs Projektimin	10 0.17%
Njoftim konkurs projektimi -Hapja e Ofertave financiare	2 0.03%
Njoftim i anulimit te kontrates	33 0.56%
Njoftim per informata shtese ose permiresim i gabimit	49 0.83%
<b>TOTAL</b>	<b>5,915 100%</b>

Në disa raste, njoftimet e publikuara janë anuluar para shpalljes së njoftimit për dhënie të kontratës. Konkretisht nga 2,234 njoftime për kontrata, para dhënies së tyre janë anuluar 24% apo shprehur në numra, janë bërë 539 anulime.

b) Të dhënat e detajuara përanulimet para dhënies së kontratave në nivelin lokal janë të paraqitura në tabelën e mëposhtme:


Anulimet	Numri
Ne mungese te ofertave te pergjegjshme	322 60%
Opinion te AKK	8 1%
Tejkalim substancial i buxhetit	69 13%
Te dhena te pamjaftueshme	71 13%
Te tjera	54 10%
OSHP	15 3%
<b>TOTAL</b>	<b>539</b> <b>100%</b>

Norma e anulimit të njoftimeve nga viti 2014 në 2015, praktikisht nuk ka ndryshuar, me diferencë prej vetëm 1%. Gjatë vitit 2014 ishin anuluar 23% e totalit të njoftimeve për kontratë. Ndërkaq në vitin 2015 janë anuluar 24% e njoftimeve.

Në anën tjetër, ndryshimet nga viti paraprak vërehen te arsyet e anulimit. Është vërejtur që kategoria e anulimeve në **mungesë të ofertave**

**të përgjegjshme ka shënuar rritje nga 43% sa ishte në vitin 2014, në 60% për vitin pasues.**

Në vitin 2015 kategoria e anulimeve tjera - ku përfshihen anulimet para hapjes së ofertave dhe gabimeve teknike të autoriteteve kontraktuese **është zvogëluar dukshëm në 10%, krahasuar me vitin 2014 që ishte 24% nga numri total i anulimeve.**



Numri i anulimeve të njoftimeve për shkak opinionit të Agjencionit Kundër Korrupsionit (AKK) është i papërfillshëm, në nivelin e 1% të totalit të njoftimeve për vitin 2015, po aq sa ishte edhe në vitin 2014.

**Opinionet e Agjencisë Kundër Korrupsionit:** Pesha e opinionëve të AKK-së mbi kontratat e komunave të Kosovës pasqyrohet në masën e zbatimit të këtyre rekomandimeve. Nga 22 opinione që ka lëshuar AKK-ja në vitin 2015, komunat kanë marrë për bazë 8 prej tyre duke kryer anulimet përkatëse para dhënies së kontratave.

Komunat që e kanë respektuar opinionin e AKK-së janë: Komuna e Gjilanit<sup>14 15</sup> në dy raste, Komuna e Dragashit në një rast<sup>16</sup>, Komuna e Pejës<sup>17 18</sup> në dy raste, Komuna e Prishtinës<sup>19</sup> në një rast, Komuna e Skenderajt<sup>20</sup> në një rast dhe ajo e Vushtrrisë<sup>21</sup> në një rast.

Në të njejtën kohë, megjithëse disa komuna kishin anuluar njoftimet bazuar në opinionin e Agjencisë Kundër Korrupsionit, kjo nuk ishte reflektuar fare në formularët standard. Raste të tilla kishin ndodhur në tre trenderë në komunën e Deçanit<sup>22</sup>, tre në komunën e Ferizajt<sup>23 24 25</sup>, një në komunën e Graçanicës<sup>26</sup>, tri në komunën e Leposaviqit<sup>27</sup>, një në komunën e Rahovecit<sup>28</sup> dhe dy në komunën e Lipjanit.<sup>29 30</sup>

14 Agjencia kundër Korrupsionit "Opinion Komunës së Gjilanit", mars 2015 <http://www.akk-ks.org/repository/docs/opinion-K.Gjilanit-dpkpp.pdf>

15 Agjencia kundër Korrupsionit "Opinion Komunës së Gjilanit", dhjetor 2015 [http://www.akk-ks.org/repository/docs/Opinion\\_Komuna\\_Gjilan\\_977710.pdf](http://www.akk-ks.org/repository/docs/Opinion_Komuna_Gjilan_977710.pdf)

16 Agjencia kundër korrupsionit "Opinion Komunës së Dragashit", prill 2015 <http://www.akk-ks.org/repository/docs/opinion-K.Dragashit-dpkpp.pdf>

17 Agjencia kundër korrupsionit "Opinion Komunës së Pejës", qershor 2015 [http://www.akk-ks.org/repository/docs/opinion-dpkpp-Komuna\\_e\\_Pejes\\_\(1\)\\_461424.pdf](http://www.akk-ks.org/repository/docs/opinion-dpkpp-Komuna_e_Pejes_(1)_461424.pdf)

18 Agjencia kundër korrupsionit "Opinion Komunës së Pejës", tetor 2015 [http://www.akk-ks.org/repository/docs/opinion\\_dpkpp-K.Pejes\\_380430.pdf](http://www.akk-ks.org/repository/docs/opinion_dpkpp-K.Pejes_380430.pdf)

19 Agjencia kundër korrupsionit "Opinion komunës së Prishtinës", dhjetor 2015 [http://www.akk-ks.org/repository/docs/opinion\\_dpkpp-K.Prishtines\\_96306.pdf](http://www.akk-ks.org/repository/docs/opinion_dpkpp-K.Prishtines_96306.pdf)

20 Agjencia kundër korrupsionit "Opinion komunës së Skenderajt", tetor 2015 [http://www.akk-ks.org/repository/docs/opinion\\_dpkpp-K.Skenderajt\\_913132.pdf](http://www.akk-ks.org/repository/docs/opinion_dpkpp-K.Skenderajt_913132.pdf)

21 Agjencia kundër korrupsionit "Opinion komunës së Vushtrrisë", dhjetor 2015 [http://www.akk-ks.org/repository/docs/opinion\\_dpki-K.Vushtrrise-\\_Fadil\\_Muzaqi\\_35226.pdf](http://www.akk-ks.org/repository/docs/opinion_dpki-K.Vushtrrise-_Fadil_Muzaqi_35226.pdf)

22 Agjencia kundër korrupsionit "Opinion komunës së Deçanit", korrik 2015 [http://www.akk-ks.org/repository/docs/opinion\\_dpkpp-K.Decanit\\_515314.pdf](http://www.akk-ks.org/repository/docs/opinion_dpkpp-K.Decanit_515314.pdf)

23 Agjencia kundër korrupsionit "Opinion komunës së Ferizajt", gusht 2015 [http://www.akk-ks.org/repository/docs/01-2254-15-dpkpp-opinion-K.Ferizajt\\_727597.pdf](http://www.akk-ks.org/repository/docs/01-2254-15-dpkpp-opinion-K.Ferizajt_727597.pdf)

24 Agjencia kundër korrupsionit "Opinion komunës së Ferizajt", gusht 2015 [http://www.akk-ks.org/repository/docs/opinion\\_dpkpp-K.Ferizajt\\_508268.pdf](http://www.akk-ks.org/repository/docs/opinion_dpkpp-K.Ferizajt_508268.pdf)

25 Agjencia kundër korrupsionit "Opinion komunës së Ferizajt", janar 2015 <http://www.akk-ks.org/repository/docs/01-100-2015%20Opiniononi%20Komuna%20e%20Ferizajt.pdf>

26 Agjencia kundër korrupsionit "Opinion komunës së Graçanicës", gusht 2015 [http://www.akk-ks.org/repository/docs/opinion-dpkpp-K.Gracanices\\_820378.pdf](http://www.akk-ks.org/repository/docs/opinion-dpkpp-K.Gracanices_820378.pdf)

27 Agjencia kundër korrupsionit "Opinion komunës së Leposaviqit", tetor 2015 [http://www.akk-ks.org/repository/docs/opinion\\_dpkpp-K.Leposaviqi\\_581383.pdf](http://www.akk-ks.org/repository/docs/opinion_dpkpp-K.Leposaviqi_581383.pdf)

28 Agjencia kundër korrupsionit "Opinion komunës së Rahovecit", qershor 2015 [http://www.akk-ks.org/repository/docs/opinion\\_dpkpp-Komuna\\_e\\_Rahovecit\\_\(1\)\\_768463.pdf](http://www.akk-ks.org/repository/docs/opinion_dpkpp-Komuna_e_Rahovecit_(1)_768463.pdf)

29 Agjencia kundër korrupsionit "Opinion komunës së Lipjanit", mars 2015 <http://www.akk-ks.org/repository/docs/opinion-K.Lipjanit-dpkpp.pdf>

30 Agjencia kundër korrupsionit "Opinion komunës së Lipjanit", mars 2015 <http://www.akk-ks.org/repository/docs/opinion-K.Lipjanit-dpkpp.pdf>



Në anën tjetër komuna e Zveçanit<sup>31 32</sup> në dy raste nuk i ka përfillur fare opinionet e AKK-së dhe ka vazhduar me dhënien e kontratave.

Nga 5,915 njoftime të publikuara prej tyre 3,023 janë njoftime për dhënie të kontratës, në mesin e të cilave prin kategoria e kontratave të mesme me 1,530 njoftime për dhënie apo shprehur në përqindje me 51%. Më pas, kategoria e kontratave të vogla me 1,420 njoftime për dhënie apo 46%, ndërsa kontratat e mëdha me 91 njoftime për dhënie apo 3%.


Kategoria e kontratave të mesme prin edhe për nga vlera monetare me pjesëmarrje prej 68% apo 108 milionë euro. Pas tyre rangohen kontratat e mëdha me pjesëmarrje prej 26% apo 42 milionë euro ndërsa si kategori e fundit klasifikohen kontratat e vogla me pjesëmarrje prej 6% apo 9.7 milionë euro, nga total prej 160 milionë euro.

Si në numër po ashtu edhe në vlerë të kontratave gjatë vitit 2015 është vërejtur rritje e dhënies së kontratave nga niveli lokal, krahasuar me vitin paraprak.

	Vlera e kontratave	Numri, Shuma
Të mëdha	Të mëdha	91 3%
	Shuma e kontratave të mëdha	42,140,507 26%
Të mesme	Të mesme	1,530 51%
	Shuma e kontratave të mesme	108,081,269 68%
Të vogla	Të vogla	1,402 46%
	Shuma e kontratave të vogla	9,742,930 6%
	<b>Total kontrata në numër</b>	<b>Total kontrata në vlerë</b>
	3,023	159,964,706
	100%	100%

31 Agjencia kundër korrupsionit "Opinion komunës së Zveçanit", dhjetor 2015 [http://www.akk-ks.org/repository/docs/opinion\\_dpkpp-K.Zvecanit\\_457230.pdf](http://www.akk-ks.org/repository/docs/opinion_dpkpp-K.Zvecanit_457230.pdf)

32 Agjencia kundër korrupsionit "Opinion komunës së Zveçanit", tetor 2015 [http://www.akk-ks.org/repository/docs/opinion\\_dpkpp-K.Zvecanit\\_2810201515052600\\_610549.pdf](http://www.akk-ks.org/repository/docs/opinion_dpkpp-K.Zvecanit_2810201515052600_610549.pdf)



Dhënia e kontratave në numër është rritur për 19%. Konkretisht, nga 2,450 kontrata sa ishin në vitin 2014 numri i dhënies së kontratave ka shkuar në 3,023 gjatë vitit 2015, përderisa dhënia e kontratave në vlerë u rrit për 43%; nga 90,4 milionë sa ishte në vitin 2014 kjo shumë arriti vlerën 160 milionë në vitin 2015.

Gjatë vitit 2015, Zyra Auditorit Gjeneral ka evidentuar shkelje të shumta të ligjit dhe procedurave të prokurimit, shkelje të kushteve kontraktuale si dhe papërgjegjësi në shpenzimin e buxhetit në komunat e Kosovës.

Sipas raporteve të auditorit disa komuna si ato të Kaçanikut<sup>33</sup>, Zveçanit<sup>34</sup>, Leposaviçit<sup>35</sup>, Zubin Potokut<sup>36</sup> nuk kanë pasur fare plan të prokurimit. Në disa komuna tjera si në Graçanicë<sup>37</sup> në pesë

raste, Viti<sup>38</sup> një rast, Junik<sup>39</sup> një rast, Deçan<sup>40</sup> një rast, Kaçanik<sup>41</sup> 28 raste, Mitrovicë<sup>42</sup> katër raste ka pasur vonesa në punime dhe nuk janë respektuar kushtet e kontratës gjë që dëshmon papërgjegjësinë e Menxherit të Kontratës dhe mos ndëshkim nga ana e komunave për Operatorët Ekonomikë.

Kontrata pa procedura të prokurimit që dëshmon papërgjegjësi në shpenzimin e parasë publike ka pasur në komunën Pejës<sup>43</sup>, Parteshit<sup>44</sup>,

33 Zyra e Auditorit të përgjithshëm, "Raporti i auditimit për pasqyrat financiare të komunës së Kaçanikut për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014", qershor 2015 [http://www.oag-rks.org/repository/docs/2\\_Kacanik\\_Raporti\\_i\\_auditimit\\_-\\_ALB\\_177720.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/2_Kacanik_Raporti_i_auditimit_-_ALB_177720.pdf)

34 Zyra e Auditorit të përgjithshëm, "Raporti i auditimit për pasqyrat financiare të komunës së Zveçanit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014", qershor 2015 [http://www.oag-rks.org/repository/docs/sq\\_raporti\\_final\\_zvecan\\_804282.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/sq_raporti_final_zvecan_804282.pdf)

35 Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, "Raporti i auditimit për pasqyrat financiare të komunës së Leposaviçit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014", qershor 2015 [http://www.oag-rks.org/repository/docs/sq\\_Raporti\\_Final\\_Leposavic\\_414164.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/sq_Raporti_Final_Leposavic_414164.pdf)

36 Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, "Raporti i auditimit për pasqyrat financiare të komunës së Zubin Potokut për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014", qershor 2015 [http://www.oag-rks.org/repository/docs/sq\\_Raporti\\_Final\\_Zubon\\_Potok\\_471482.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/sq_Raporti_Final_Zubon_Potok_471482.pdf)

37 Zyra e Auditorit të përgjithshëm "Raporti i auditimit për pasqyrat financiare të komunës së Graçanicës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014", qershor 2015 [http://www.oag-rks.org/repository/docs/sq\\_Raporti\\_Final\\_Gracanica\\_2014\\_257937.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/sq_Raporti_Final_Gracanica_2014_257937.pdf)

38 Zyra e Auditorit të përgjithshëm "Raporti i auditimit për pasqyrat financiare të komunës së Graçanicës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014", qershor 2015 [http://www.oag-rks.org/repository/docs/6\\_Vitia\\_Raporti\\_i\\_auditimit\\_-\\_ALB\\_469557.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/6_Vitia_Raporti_i_auditimit_-_ALB_469557.pdf)

39 Zyra e Auditorit të përgjithshëm "Raporti i auditimit për pasqyrat financiare të komunës së Junikut për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014", qershor 2015 [http://www.oag-rks.org/repository/docs/5\\_Junik\\_Raporti\\_i\\_Auditimit\\_-\\_ALB\\_569266.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/5_Junik_Raporti_i_Auditimit_-_ALB_569266.pdf)

40 Zyra e Auditorit të përgjithshëm "Raporti i auditimit për pasqyrat financiare të komunës së Deçanit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014", qershor 2015 [http://www.oag-rks.org/repository/docs/4\\_Decan\\_Raporti\\_i\\_Auditimit\\_-\\_ALB\\_396527.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/4_Decan_Raporti_i_Auditimit_-_ALB_396527.pdf)

41 Zyra e Auditorit të përgjithshëm "Raporti i auditimit për pasqyrat financiare të komunës së Kaçanikut për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014", qershor 2015 [http://www.oag-rks.org/repository/docs/2\\_Kacanik\\_Raporti\\_i\\_auditimit\\_-\\_ALB\\_177720.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/2_Kacanik_Raporti_i_auditimit_-_ALB_177720.pdf)

42 Zyra e Auditorit të përgjithshëm "Raporti i auditimit për pasqyrat financiare të komunës së Kaçanikut për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014", qershor 2015 [http://www.oag-rks.org/repository/docs/2\\_Kacanik\\_Raporti\\_i\\_auditimit\\_-\\_ALB\\_177720.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/2_Kacanik_Raporti_i_auditimit_-_ALB_177720.pdf)

43 Zyra e Auditorit të përgjithshëm "Raporti i auditimit për pasqyrat financiare të komunës së Pejës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014", qershor 2015 [http://www.oag-rks.org/repository/docs/sq\\_Raporti\\_Final\\_Peja\\_188865.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/sq_Raporti_Final_Peja_188865.pdf)

44 Zyra e Auditorit të përgjithshëm "Raporti i auditimit për pasqyrat financiare të komunës së Parteshit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014", qershor 2015 [http://www.oag-rks.org/repository/docs/sq\\_Raporti\\_Final\\_Partesh\\_530962.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/sq_Raporti_Final_Partesh_530962.pdf)

Obiliqit<sup>45</sup>, e Rahovecit<sup>46</sup>. Ndër papërgjegjësitë e shpenzimeve të buxhetit është pagesa e shërbimit pa u kryer puna siç ka ndodhur në komunën e Graçanicës<sup>47</sup> dhe Shtërpces<sup>48</sup>. Po ashtu në këtë kategori shkeljesh është edhe lidhja e kontratave duke e tejkaluar buxhetin e planifikuar për atë kontratë siç ka ndodhur në komunat e Prizrenit<sup>49</sup>, Pejës<sup>50</sup>, Hanit të Elezit<sup>51</sup>, Rahovecit<sup>52</sup> e Klinës.<sup>53</sup>

Një planifikim të dobët dhe shkelje të ligjit të prokurimit sipas auditorit e tregojnë rastet kur disa komuna kanë përdorur mbi 50% të kontratave të vogla të kuotimit me operatorë të njëjtë ekonomikë si dhe ndarjen e tenderëve

45 Zyra e Auditorit të përgjithshëm "Raporti i auditimit për pasqyrat financiare të komunës së Obiliqit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014", qershor 2015 [http://www.oag-rks.org/repository/docs/sq\\_Raporti\\_Final\\_Obiliq\\_443309.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/sq_Raporti_Final_Obiliq_443309.pdf)

46 Zyra e Auditorit të përgjithshëm "Raporti i auditimit për pasqyrat financiare të komunës së Rahovecit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014", qershor 2015 [http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit\\_KRA\\_2014\\_Shqip\\_228583.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_KRA_2014_Shqip_228583.pdf)

47 Zyra e Auditorit të përgjithshëm "Raporti i auditimit për pasqyrat financiare të komunës së Graçanicës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014", qershor 2015 [http://www.oag-rks.org/repository/docs/sq\\_Raporti\\_Final\\_Graçanica\\_2014\\_257937.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/sq_Raporti_Final_Graçanica_2014_257937.pdf)

48 Zyra e Auditorit të përgjithshëm "Raporti i auditimit për pasqyrat financiare të komunës së Shtërpces për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014", qershor 2015 [http://www.oag-rks.org/repository/docs/sq\\_Raporti\\_Final\\_Shterpc\\_2014\\_246831.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/sq_Raporti_Final_Shterpc_2014_246831.pdf)

49 Zyra e Auditorit të përgjithshëm "Raporti i auditimit për pasqyrat financiare të komunës së Prizrenit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014", qershor 2015 [http://www.oag-rks.org/repository/docs/sq\\_Raporti\\_Final\\_Prizren\\_327559.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/sq_Raporti_Final_Prizren_327559.pdf)

50 Zyra e Auditorit të përgjithshëm "Raporti i auditimit për pasqyrat financiare të komunës së Pejës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014", qershor 2015 [http://www.oag-rks.org/repository/docs/sq\\_Raporti\\_Final\\_Peja\\_188865.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/sq_Raporti_Final_Peja_188865.pdf)

51 Zyra e Auditorit të përgjithshëm "Raporti i auditimit për pasqyrat financiare të komunës së Hanit të Elezit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014", qershor 2015 [http://www.oag-rks.org/repository/docs/sq\\_Raporti\\_Final\\_Hani\\_i\\_E\\_282786.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/sq_Raporti_Final_Hani_i_E_282786.pdf)

52 Zyra e Auditorit të përgjithshëm "Raporti i auditimit për pasqyrat financiare të komunës së Rahovecit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014", qershor 2015 [http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit\\_KRA\\_2014\\_Shqip\\_228583.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_KRA_2014_Shqip_228583.pdf)

53 Zyra e Auditorit të përgjithshëm "Raporti i auditimit për pasqyrat financiare të komunës së Klinës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014", qershor 2015 [http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit\\_KKL\\_2014\\_Shqip\\_570029.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_KKL_2014_Shqip_570029.pdf)

në tenderë të vegjël me kuotim nën vlerën 10 mijë euro ku nuk bëhet thirrje për tender, duke shmangur procedurat e hapuratë prokurimit siç janë rastet në komunat e Mitrovicës së Veriut<sup>54</sup>, Drenasit<sup>55</sup>, Klinës<sup>56</sup>, Gjilanit<sup>57</sup>, Ferizajt<sup>58</sup>, Lipjanit<sup>59</sup>, Kamenicës<sup>60</sup> dhe Mitrovicës<sup>61</sup>.

54 Zyra e Auditorit të përgjithshëm "Raporti i auditimit për pasqyrat financiare të komunës së Mitrovicës Veriore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014", qershor 2015 [http://www.oag-rks.org/repository/docs/sq\\_Raporti\\_Final\\_M\\_Verore\\_846873.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/sq_Raporti_Final_M_Verore_846873.pdf)

55 Zyra e Auditorit të përgjithshëm "Raporti i auditimit për pasqyrat financiare të komunës së Glogocit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014", qershor 2015 [http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit\\_KDR\\_2014\\_Shqip\\_27249.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_KDR_2014_Shqip_27249.pdf)

56 Zyra e Auditorit të përgjithshëm "Raporti i auditimit për pasqyrat financiare të komunës së Klinës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014", qershor 2015 [http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit\\_KKL\\_2014\\_Shqip\\_570029.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_KKL_2014_Shqip_570029.pdf)

57 Zyra e Auditorit të përgjithshëm "Raporti i auditimit për pasqyrat financiare të komunës së Gjilanit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014", qershor 2015 [http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit\\_KGL\\_2014\\_Shqip\\_785801.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_KGL_2014_Shqip_785801.pdf)

58 Zyra e Auditorit të përgjithshëm "Raporti i auditimit për pasqyrat financiare të komunës së Ferizajt për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014", qershor 2015 [http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit\\_KFE\\_2014\\_Shqip\\_627345.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_KFE_2014_Shqip_627345.pdf)

59 Zyra e Auditorit të përgjithshëm "Raporti i auditimit për pasqyrat financiare të komunës së Lipjanit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014", qershor 2015 [http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit\\_KLIP\\_2014\\_Shqip\\_655308.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_KLIP_2014_Shqip_655308.pdf)

60 Zyra e Auditorit të përgjithshëm "Raporti i auditimit për pasqyrat financiare të komunës së Kamenicës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014", qershor 2015 [http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit\\_KKM\\_2014\\_Shqip\\_592097.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_KKM_2014_Shqip_592097.pdf)

61 Zyra e Auditorit të përgjithshëm "Raporti i auditimit për pasqyrat financiare të komunës së Mitrovicës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014", qershor 2015 [http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit\\_KMT\\_2014\\_Shqip\\_989613.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_KMT_2014_Shqip_989613.pdf)

## Rastet e shkeljeve në tendere të raportuara në mediat tona

1. Gjatë vitit 2015 BIRN raportoi në lidhje me keqpërdorimet me tenderë nga disa komuna të Kosovës.

Gazeta Jeta në Kosovë ka zbuluar se Komuna e Mitrovicës lidhi kontratë publike me firmën "Ariani" që është në pronësi të babait dhe xhaxhallarëve të drejtorit të prokurimit, Besnik Beka. Përveç afërsisë familjare, komuna e Mitrovicës bazuar në gjetjet e auditorëve, nuk dorëzoi njoftimin për dhënie të kontratës në KRPP. Po ashtu firma "Ariani" u pagua dyfish më shtrenjtë sesa një kompani tjetër që bën të njëjtën punë. Kajtas Peci, pronar i firmës konkurrense "Unioni", lidhur me përfitimet e firmës "Ariani" nga komuna thapër BIRN se "kush rri nën dardha, han dardha".<sup>62</sup>

Komuna madje ishte munduar t'ia hedhë fajin KRPP-së me arsyetimin se për shkak të problemeve teknike, KRPP-ja nuk e ka publikuar njoftimin për dhënie të kontratës në uebfaqen e vet.

Pas raportimit në Gazetën Jeta në Kosovë dhe kërkesës për monitorim të këtij tenderi, KRPP-ja vërtetoi se Komuna e Mitrovicës ka bërë shkelje ligjore gjatë zbatimit të prokurimit si dhe ka bërë shkelje etike duke dhënë deklarime jo reale për problemet teknike të uebfaqes së tyre. Pas kësaj KRPP-ja kërkoi nga Komuna e Mitrovicës që t'i evitojë shkeljet, e në rast se KRPP-ja konstaton shkelje tjetër ligjore të zyrtarëve të komunës së Mitrovicës do të ndërmarë masa konform dispozitave ligjore.<sup>63</sup>

Gazeta Jeta në Kosovë raportin e lëshuar të KRPP-së mbi monitorimin e rastit në fjalë e ka cilësuar si amnesti ndaj shkeljes ligjore me të cilën ka vepruar Komuna e Mitrovicës.<sup>64</sup>

62 Artikulli "Tender sekret për babanë", shtator 2015 <http://kallxo.com/gjnk/tender-sekret-per-babane/>

63 KRPP, "Vërejtje komunës së Mitrovicës", shtator 2015 [https://krpp.rks-gov.net/krpp/PageFiles/File/Dep\\_MM/Shqip/2015/njoftim-25.09.2015.pdf](https://krpp.rks-gov.net/krpp/PageFiles/File/Dep_MM/Shqip/2015/njoftim-25.09.2015.pdf)

64 Artikulli "Tenderi familjar fut në konflikt Mitrovicën me KRPP-në", shtator 2015 <http://kallxo.com/gjnk/tenderi-familjar-fut-ne-konflikt-mitrovicen-me-krpp-ne/>

2. Një komunë tjetër, ajo e Pejës, gjatë vitit 2015 u përball me akuza dhe zhurmë për tenderin në vlerë 2.5 milionë euro për rregullimin e murit mbrojtës dhe shetitores së Lumbardhit.

Ky tender iu dha kompanisë "Enex Trade" me referenca të falsifikuara, sipas të cilave, kjo firmë kishte ndërtuar një objekt banesor privat, përderisa AKK-ja vërtetoi se këtë objekt e kishte ndërtuar një kompani tjetër e jo "Enex Trade". Kryetari i Pejës Gazmend Muhaxheri tentoi ta anulonte tenderin ani pse kontrata ishte lidhur, duke dhënë si arsytim mungesën buxhetore, por OSHP-ja nuk e lejoi. Konradiktat në mes dy raporteve të ekspertizave të bëra nga eksperti i brendshëm dhe i jashtëm i OSHP-së çuan këtë tender dy herë në rivlerësim.

Pas rivlerësimit të parë, tenderi prapë iu dha kompanisë së njëjtë "Enex Trade", e cila aplikoi në konzorcium me një kompani tjetër. Rivlerësimi i dytë nga Komuna rezultoi me anulim të dhënies së tenderit - pasiqë ishte vlerësuar se për këtë tender ishte përgjegjës vetëm një operator ekonomik.<sup>65</sup>

Por vlerësimin për t'ia dhënë tenderin edhe herën e dytë kompanisë "Enex Trade" e bëri komisioni vlerësues i kundërligjshëm dhe jo profesional,

Gëzim Lajqi shef i logjistikës me diplomë të zjarrfikësit, Dardan Muhaxheri i cili kishte qenë herën e parë në komision vlerësues ishte caktuar edhe për herën e dytë që është e kundërligjshme, si dhe Sokol Kanolli asistent për fajllimin e dokumentacionit në zyrën e Prokurimit me kontratë mbi vepër ishin treshja nga komisioni që vlerësuan tenderin 2.5 milion euro, për herën e dytë.

Kur u mendua se gjithçka përfundoi me Lumbardhin e Pejës, operatorët ekonomikë u ankuan prapë në OSHP. Ky tender ka një vit që nuk po finalizohet pavarësisht që Komuna e Pejës mori vendim për anulim.

Secila palë po kërkon të drejtat e veta, eksperti i tretë i OSHP vlerësoi se për këtë tender është

65 Artikulli "Mullari i Shkeljeve të tenderit të Lumbardhit", janar 2016 <http://kallxo.com/gjnk/mullari-i-shkeljeve-te-tenderit-te-lumbardhit/>

i përgjegjëm vetëm një operator ekonomik dhe tenderi duhet të anulohet.<sup>66</sup>

Një gjë të tillë nuk po e mendon Paneli Shqyrtues i OShP-së ani pse kompania “Enex Trade” u shpall e papërgjegjshme nga dy ekspertë. Me vetëm një ofertë të përgjegjshme në këtë tender, u vendos që lënda ta kthehet në ri-vlerësim për të tretën herë.<sup>67</sup>

\*\*\*

3. Komuna e Skënderajt furnizohet me naftë nga firma e një asamblisti të PDK-së në Kuvendin Komunal, Musa Hajdari.

Musa Hajdari, bashkëpronar i kompanisë së naftës “Alfa Trade”, lidhi kontratë me Komunën e Skënderajt për furnizim me derivate në vlerë prej 250 mijë euro në mars 2015.

Para se të bëhej asamblist, Musa Hajdari ishte këshilltar komunal që nga viti 2007, ndërsa pozitën që ai e mban aktualisht më herët e mbante vëllai i tij Hajdar Hajdari. Musa dhe Hajdari si bashkëpronarët e “Alfa Trade” furnizuan komunën me derivate edhe në vitin 2012.

Sipas komunës, kjo nuk paraqiste konflikt interesi sepse Musa Hajdari nuk kishte rol në procedurat e prokurimit e në anën tjetër kompania i kishte plotësuar kushtet, ndaj dhe ishte shpërblyer me tender. AKK-ja është duke trajtuar rastin për të parë se a ekziston konflikt interesi, kur një asamblist nuk mund të jetë pronar apo bashkëpronar në një kompani private.<sup>68</sup>

4. Pa tenderë nuk u lanë as të afërmit e njerëzve të PDK-së në Drenas. Kompania “Trasing Group” u shpërblye me tender për asfaltim në vlerë prej 1.8 milion euro nga ish-punëtori i kësaj kompanie Betim Berisha, sot

drejtor i Urbanizimit në Komunën e Drenasit. “Trasing Group” doli të jetë kompania e axhës së Betim Berishës, Demir Berishës, i cili para se djali i vëllait ta merrte postin e drejtorit të urbanizimit ia kishte besuar atij punën e menaxherit në kompani.

“Trasing Group” edhe gjatë viteve të mëhershme kishte marrë tenderë nga kjo komunë, për shkak të lidhjeve familjare me persona në pushtet. Praktishtë, këshilltari i kësaj kompanie Ferat Shala sot është zëvendësministër i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, e në anën tjetër motra e Demir Berishës, Sala Berisha-Shala, njëkohësisht bashkëshortja e Ferat Shalës, sot është deputete e PDK-së dhe anëtare e Komisionit Parlamentar për Zhvillim Ekonomik nga kjo parti.<sup>69</sup>

5. Një tjetër hulumtim që tregon favorizime në shpërblyerjen me tenderë për kompani të parapëlqyera kanë përdorur edhe komunat e Veriut të Kosovës kur në vitin 2015, Mitrovica e Veriut, Zveçani dhe Zubin Potoku filluan shfrytëzimin e buxhetit për investime kapitale.

Investimet prej 6.2 milionë euro për asfaltim të rrugëve i fitoi pa konkurrencë kompania “RAD” e pronarit Radule Steviç, duke krijuar në këtë mënyrë një situatë monopoli.

Favorizimin për këtë kompani e bëri vetë Komuna e Zveçanit duke e shkelur ligjin e Prokurimit Publik, me kërkesën që referencat e punëve të kryera më herët të **ishin vetëm nga komunat e Veriut** e të cilat i kishte vetëm kompania “RAD” e Radule Steviçit.<sup>70</sup>

66 Artikulli “Tenderi Kaotik i Lumbardhit në Pejë Ngëc në OShP” ,maj 2016 <http://kallxo.com/gjnk/tenderi-kaotik-lumbardhit-ne-peje-ngec-ne-oshp/>

67 Vendimi i Oragnit Shqyrtues të Prokurimit, Ndërtimi i murit mbrojtës dhe shetitorja e Lumbardhit-Ritender, maj 2016 [https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2016/50-51-52-53-16vendim\\_1.PDF](https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2016/50-51-52-53-16vendim_1.PDF)

68 Artikulli “Qindra mijëra € për firmën e asamblistit të PDK-së”, tetor 2015 <http://kallxo.com/gjnk/qindra-mijera-per-firmen-e-asamblistit-te-pdk-se/>

69 Artikulli “Drenasi asfaltohet nga firma e lidhur me njerëz të PDK-së”, nëntor 2015 <http://kallxo.com/gjnk/drenasi-asfaltohet-nga-firma-e-lidhur-me-njerez-te-pdk-se/>

70 Artikulli “Bosi i tenderëve të veriut”, mars 2016 <http://kallxo.com/gjnk/bosi-i-tendereve-te-veriut/>

# INSTITUCIONET E PAVARURA

Në kuadër të institucioneve të pavarura janë përfshirë 62 autoritete kontraktuese duke e ndryshuar strukturën e klasifikimit nga 82 sa ishin në vitin 2014. Gjithashtu 19 agjenci janë ndarë nga kategoria e institucioneve të pavarura, të cilat më pas janë shqyrtuar në veçanti.

Te institucionet e pavarura përfshihen organet e drejtësisë, institucionet e arsimit të lartë, autoritetet rregullative, policia, dogana, administrata tatimore dhe shërbimet shëndetësore.

a) **Tabela e mëposhtme pasqyron klasifikimin e të gjitha njoftimeve të institucioneve të pavarura të publikuara në ueb faqen e KRPP-së nga periudha 1 janar 2015 deri më 31 dhjetor 2015.**

	Numri
<b>Njoftim Kontrate</b>	<b>1,281</b> <b>40%</b>
Njoftim per dhenie te kontrates	1,262 40%
<b>Njoftim anulimi</b>	<b>584</b> <b>18%</b>
Njoftim paraprak	7 0.22%
<b>Njoftim mbi rezultatin e konkursit</b>	<b>2</b> <b>0.06%</b>
Njoftim mbi konkurs Projketimin	1 0.03%
<b>Njoftim i anulimit te kontrates</b>	<b>27</b> <b>0.85%</b>
Njoftim per informata shtese ose permiresim i gabimit	27 0.85%
<b>TOTAL</b>	<b>3,191</b> <b>100%</b>

Nga 3,191 njoftime të publikuara, njoftimet për kontratë si thirrje për tenderë dhe gjithashtu njoftimet që rezultojnë me nënshkrim të kontratave, kanë pjesëmarrje të barabartë me 40 për qind.

Njoftimet e publikuara në disa raste janë anuluar para dhënies së kontratës. Nga 1.281 njoftime për kontrata, para dhënies së tyre janë anuluar 584 apo 46 për qind.

**b) Tabela e mëposhtme paraqet arsyet e këtyre anulimeve**

Anulimet	Numri
Ne mungese te ofertave te pergjegjshme	369 63%
Opinion te AKK	3 1%
Tejkalim substancial i buxhetit	43 7%
Te dhena te pamjaftueshme	78 13%
Te tjera	69 12%
OSHP	22 4%
<b>TOTAL</b>	<b>584</b> <b>100%</b>

Prej arsyeve më të shpeshta të anulimeve del të jetë mungesa e ofertave të përgjegjshme. Nga 584 njoftime për anulime, 369 njoftime apo 63 përqind ishin anuluar si pasojë e mungesës së ofertave të përgjegjshme.

Nga kjo e dhënë kuptohet se kriteret e vendosura në dosjen e tenderëve shpesh herë kanë mangësi në përshkrim të saktë dhe të qartë të dokumenteve të kërkuara, dhe në disa raste kjo ndodh edhe për favorizim të operatorëve ekonomikë të caktuar.

**Gjatë vitit 2015, AKK-ja publikoi 11 opinione me rekomandime për anulime të aktivitetit të prokurimit. Vetëm dy opinione ishin marrë parasysh nga institucionet publike, një aktivitete e anuloi QKUK-ja<sup>71</sup> dhe një Spitali Ferizaj <sup>72</sup>. Në anën tjetër, 9 rekomandime të tjera mbetën pa u shqyrtuar nga 7 institucione.**

Aktivitet e prokurimit për shkak opinionit të AKK-së nuk u deklaruan se i anuluan Shërbimi Klinik Spitalor Universitar<sup>73 74 75 76</sup> në katër raste, Administrata Tatimore e Kosovës<sup>77</sup> në një rast, Sekretariati Këshillit Gjyqësor të Kosovës<sup>78</sup> në

një rast, Spitali Rajonal i Gjilanit<sup>79</sup> në një rast, Spitali Rajonal Mitrovicës<sup>80</sup> në një rast.

Ekziston edhe një rast, kur opinion për anulimin e aktivitet të prokurimit AKK-ja lëshoi për vet gjykatën e tenderëve Organin Shqyrtues të Prokurimit<sup>81</sup>, e cila e shpërfilli këtë opinion dhe vazhdoi me procura të prokurimit. Opinioni ishte lëshuar për tenderin e shërbimeve të përkthimit nga gjuha shqipe në gjuhën serbe-kroate dhe anasjelltas, ku thuhej se OShP-ja ka bërë shkelje të ligjit të prokurimit, duke pranuar referenca nga Operatorët Ekonomikë edhe të vitit 2015, përderisa referencat është dashur të jenë të vitit 2012, 2013 dhe 2014.

BIRN përmes emailit kërkoi nga OShP-ja të ofrojë sqarime rreth opinionit të AKK-së, por OShP-ja nuk ktheu përgjigje. Megjithatë, BIRN iu drejtua KRPP-së duke kërkuar një interpretim ligjor nëse është dashur që OShP-ja ta anulojë këtë aktivitet të prokurimit pasi që AKK-ja e kishte rekomanduar diçka të tillë.

Në përgjigjen e saj KRPP kishte thënë se opinionet e AKK-së nuk janë obligative të zbatohen, por janë të mirëpritura.

*“Opinionet e institucioneve të tjera përfshirë edhe AKK-në nuk janë obligative sipas LPP-së, por ato duhet të merren parasysh sa herë që janë të arsyeshme dhe kanë mbështetje ligjore”* thuhet nëpërgjigjen e KRPP-së.

Si duket një opinion i tillë nuk ka qenë i arsyeshëm për OShP-në e cila ka vazhduar tutje me procedura të prokurimit.

71 Agjencia kundër korrupsionit “Opinion Qendrës Klinike Universitare të Kosovës”, tetor 2015 [http://www.akk-ks.org/repository/docs/opinion\\_dpkpp-QKUK\\_388578.pdf](http://www.akk-ks.org/repository/docs/opinion_dpkpp-QKUK_388578.pdf)

72 Agjencia kundër korrupsionit “OpinionSpitalit të Ferizajt,qershorë 2015 [http://www.akk-ks.org/repository/docs/opinion-dpkpp-Spitali\\_Ferizaj\\_\(2\)\\_494511.pdf](http://www.akk-ks.org/repository/docs/opinion-dpkpp-Spitali_Ferizaj_(2)_494511.pdf)

73 Agjencia kundër korrupsionit “OpinionShërbimit Klinik Spitalor Universitar”, dhjetorë 2015 [http://www.akk-ks.org/repository/docs/opinion\\_dpkpp-Sherbimi\\_Spitalor\\_Klinik\\_dhe\\_Universitar\\_i\\_Kosov%C3%ABs\\_528026.pdf](http://www.akk-ks.org/repository/docs/opinion_dpkpp-Sherbimi_Spitalor_Klinik_dhe_Universitar_i_Kosov%C3%ABs_528026.pdf)

74 Agjencia kundër korrupsionit “OpinionShërbimit Klinik Spitalor Universitar”, tetorë 2015 [http://www.akk-ks.org/repository/docs/opinion\\_dpkpp-QKUK\\_388578.pdf](http://www.akk-ks.org/repository/docs/opinion_dpkpp-QKUK_388578.pdf)

75 Agjencia kundër korrupsionit “OpinionShërbimit Klinik Spitalor Universitar”, prill 2015 <http://www.akk-ks.org/repository/docs/opinion-%20Sherbimi%20spitalor%20Klinik%20Universitar%20.pdf>

76 Agjencia kundër korrupsionit “OpinionShërbimit Klinik Spitalor Universitar”, prill 2015 <http://www.akk-ks.org/repository/docs/opinion-dpkpp-Sherbimi%20Spitalor%20Klinik%20Universitar.pdf>

77 Agjencia kundër korrupsionit “OpinionAdministratës Tatimore të Kosovës,nëntorë 2015 [http://www.akk-ks.org/repository/docs/opinion\\_dpkpp-ATK\\_159605.pdf](http://www.akk-ks.org/repository/docs/opinion_dpkpp-ATK_159605.pdf)

78 Agjencia kundër korrupsionit “OpinionKëshillit Gjyqësor të Kosovës,maj 2015 <http://www.akk-ks.org/repository/docs/opinion-dpkpp-SKGJK.pdf>

79 Agjencia kundër korrupsionit “OpinionSpitalit Rajonal të Gjilanit, maj 2015 <http://www.akk-ks.org/repository/docs/01-1296-2015spitali%20i%20Gjilanit.pdf>

80 Agjencia kundër korrupsionit “OpinionSpitalit Rajonal të Mitrovicë, janar 2015 <http://www.akk-ks.org/repository/docs/opinion-%20Spitali%20Rajonal%20,Dr.Sami%20Haxhibeqiri-Mitrovicë.pdf>

81 Agjencia kundër korrupsionit “Opinion për OSHP”, mars 2015 <http://www.akk-ks.org/repository/docs/opinion%20OSHP-dpkpp.pdf>



c) Tabela e mëposhtme tregon detajet e numrit dhe vlerave të kontraktuara nga institucionet e pavarura për periudhën janar-dhjetor 2015

	Vlera e kontratave	Numri, Shuma
Të mëdha	Të mëdha	79 6%
	Shuma e kontratave të mëdha	25,057,910 57%
Të mesme	Të mesme	384 30%
	Shuma e kontratave të mesme	14,742,572 34%
Të vogla	Të vogla	799 63%
	Shuma e kontratave të vogla	4,200,221 10%
	Total kontrata në numër	Total kontrata në vlerë
	1,262	44,000,703
	100%	100%

Gjatë vitit 2015, institucionet e pavarura më së shumti kanë nënshkruar kontrata të vogla. Nga numri i përgjithshëm i kontratave të dhëna nga këto institucione, 799 janë kontrata të vogla çka përkthehen në 63 përqind të totalit të kontratave.


Kontratat e mesme janë 384 apo 30 përqind e totalit, ndërsa të fundit në numër janë kontratat e mëdha me 79 sosh apo 6 përqind të totalit.

Sa i përket vlerës së kontratave, situata ndryshon në krahasim me numrin e tyre. Në këtë kategori prijnë kontratat e mëdha me pjesëmarrje prej 57 përqind, në vlerën monetare prej 25 milionë euro. Pasojnë

kontratat e mesme me pjesëmarrje prej 30 përqind apo 14.7 milionë euro, si dhe kontratat e vogla me pjesëmarrje prej 10 përqind apo 4.2 milionë euro.

Në kuadër të kontratave me vlerë më të madhe prin Qendra Klinike Universitare me 7.2 milionë euro apo 28 përqind, Policia e Kosovës me 5 milionë euro apo 20 përqind, Universiteti i Prishtinës me 2.4 milionë euro apo 10 përqind, Shërbimi Spitalor Klinik me 2 milionë euro apo 8 përqind, Shërbimi Korrektues i Kosovës me 1.8 milion euro apo 7 përqind, Qendra e Studentëve me 1.2 milion euro apo 5 përqind nga totali i 25 milionëve të kontratave të mëdha.

## Kontratat e mëdha të institucioneve të pavaruara për vitin 2015



Kompanitë të cilat kanë përfituar këto miliona euro nga kontratat e mëdha prej Institucioneve publike janë disa si:

Kompanitë	Pronari	Institucioni	Titulli i kontratës	Vlera
Ko-Med Triomed Exclusive Pharma Medica-Ks Made Kos	Arben Ismajli, Ram Idrizaj Artrin Bajrami Bedri Buzuku Ylber Saliu	QKUK	Furnizim nga lista esenciale e barnave	2,548,213
Meditech	Agron Sadiku	QKUK	Furnizim me citostatik	2,102,400
Tre Pharm Meditech Redoni HM	Mergim Prishtina, Agron Sadiku, Fisnik Ymeri	QKUK	Furnizim nga lista esenciale e barnave	1,033,075
Blendi	Shaip Rama	QKUK	Furnizim me tonera	315,392
Made Kos	Bedri Buzuku	QKUK	Furnizim me Inventar medicinal	222,500

Atom Med Made Kos	Bekim Murati, Bedri Buzuku	QKUK	Furnizim nga lista esenciale e barnave	216,791
Ejona	Hysni Prevlukaj	QKUK	Servisimi dhe mirëmbajtja e ashensorëve ne QKUK	207,360
Medica - KS	Artrin Bajrami	QKUK	Servisimi dhe mirëmbajtja e aparaturës në Radioterapi	196,320
Amitech Copy Service InterSoft-a Computer	Bujar Shurdhaj	QKUK	Furnizim me pay per print dhe mirembajtja e fotokopjeve Toshiba	167,500
Keis Pharmaceuticals	Shkelqim Kabashi	QKUK	Furnizimi me material hargjues për Biokimi	154,675
			Total	7,164,226

Kompanitë	Pronari	Institucioni	Titulli i kontratës	Vlera
KATANA	Skender Ruhani	Policia e Kosovës	Furnizim me sprej,gaz Lotsjellës dhe granata për Policinë e Kosovës	1,600,286
KATANA	Skender Ruhani	Policia e Kosovës	Furnizim me top uji Policinë e Kosovës	1,428,960
AUTEKNIK BAHOLLI	Rexhep Baholli	Policia e Kosovës	Furnizim me kombi operacional për IEDD	353,116
Reload	Shpend Zenuni	Policia e Kosovës	Furnizim me paisje Policore (armë)- 1, 2, 3	352,535

CREA-KO	Avni Ternava	Policia e Kosovës	Mirëmbajtja e sistemit PRIMS	300,000
PBC KOSOVA	Bashkim Selmani	Policia e Kosovës	Furnizim me licenca dhe programe kompjuterike - rivlersim pjesa 1	300,000
INFRA PLUS & FERPETROL		Policia e Kosovës	Ndërtimi I garazhës tipi I mbyllurnë kampin Vrella	295,600
DEKORAL & EURO CONSTRUCTION	Gani Osmanaj	Policia e Kosovës	Renovim I ibjektit të ish administratës të PK-së	283,298
VIRTUO	Glauk Hoxha	Policia e Kosovës	Furnizim me licenca dhe programe Kompjuterike - Ritender	198,163
			<b>Total</b>	<b>5,111,958</b>

Kompanitë	Pronari	Institucioni	Titulli i kontratës	Vlera
ADA Group & Altrade	Shpetim Musliu	Universiteti i Prishtinës	Ndertimi i Dekanatit të Fakultetit të Mjeksisë	1,886,787
Enex Trade Loshi Company Rexha & AF Construction	Visar Kelmendi Samir Rexha Shefqet Loshaj	Universiteti i Prishtinës	Renovimi i Amfiteatrit 408 të FNA-së	356,723
Botec		Universiteti i Prishtinës	Furnizimi me paisje të teknologjisë informative për nevojat e Universitetit të Prishtinës Hasan Prishtina	173,063
			Total	2,416,573

Kompanitë	Pronari	Institucioni	Titulli i kontratës	Vlera
Santeparm Exclusive Pharma Sinorg	Milaim Abdullahu Rame Idrizaj Shefqet Mehmetukaj	Shërbimi Klinik Spitaror	Furnizim me filma dhe pajisje percjellese	1,358,401
Kosova Med	Xhavit Asallani	Shërbimi Klinik Spitaror	Furnizim me filma dhe pajisje percjellese	623,301
			<b>Total</b>	<b>1,981,702</b>

Kompanitë	Pronari	Institucioni	Titulli i kontratës	Vlera
Beni Dona Hajdini Commerc Kualiteti	Musa Leku Ragip Mustafa	Shërbimi korrektues	Furnizim me ushqim (peme, perime, miell, buke dhe mish) për institucionet e SHKK-ës	721,623
Beni Dona	Ragip Mustafa	Shërbimi korrektues	Furnizim me cigare per te burgosur - Kantine	538,590
Loshi Design	Valmir Loshi	Shërbimi korrektues	Renovimi i brendshëm i pavijonit 5 ne Qendrën Korrektuese ne Dubravë	283,088
Unikat	Zeqir Qollaku Ahmet Kuqi	Shërbimi korrektues	Furnizim me uniforma dhe këpucë për SHKK-en	238,037
			<b>Total:</b>	<b>1,781,338</b>

Kompanitë	Pronari	Institucioni	Titulli i kontratës	Vlera
Standard Plus	Azem Lima	Qendra e Studentëve	Ndërtimi i konviktit nr. 8 Prishtinë	1,031,233
Mullisi	Enver Hajdari	Qendra e Studentëve	Furnizimi me buke dhe burek per nevoja te Qendres se Studenteve	215,000
			<b>Total:</b>	<b>1,246,233</b>

Gjatë vitit 2015, Policia e Kosovës më në fund ia besoi Agjencisë Qendrore të Prokurimit (AQP) aktivitetin e prokurimit për furnizim me automjete të nisur në vitin 2011.

AQP-ja është agjenci e pavarur përgjegjëse për kryerjen e aktiviteteve të prokurimit për institucionet buxhetore e cila themelohet nga Ministria e Financave për shkaqe të ekspertizës profesionale, efektivitetit të kostos, efikasitetit ose çështjeve të tjera legjitime.<sup>82</sup>

AQP-ka kompetenca të kryejë dy lloje të prokurimeve:

- prokurime të përbashkëta me kërkesë të Autoriteteve Kontraktuese,
- prokurime të përbashkëta për Autoritete Kontraktuese me urdhër të Ministrisë së Financave

Policia e Kosovës kërkoi vet nga AQP-ja udhëheqjen e procedurave të prokurimit, ndërsa drejtori i AQP-së Mursel Rracaj shpjegoi për BIRN si është zhvilluar ky aktivitet i prokurimit:

*“Policia e Kosovës ka gjashtë vjet që është përballur me probleme të tenderimit të automjeteve. Realizimin e këtij aktiviteti të prokurimit AQP-ja ka arritur ta zhvillojë me sukses dhe në përputhje me ligjin e vjetër me kërkesë të Autoriteteve Kontraktuese, kontrata e automjeteve është në implementim e sipër”,* tha Rracaj.

AQP-ja për Policinë e Kosovës kontrakttoi 219 automjete patrulluese të cilat nuk do të blehen përnjëherë, por sipas nevojës me kontratë kornizë për 36 muaj në vlerë prej 4.4 milionë euro nga kompania “Porche Kosova”.<sup>83</sup>

\*\*\*

Gazeta Jeta në Kosovë hulumtoi tenderin e negociuar pa publikim prej 3.3 milionë euro të Universitetit të Prishtinës (UP) me kompaninë maqedonase “Tebernakul” për furnizim me libra shkencorë, kontratë nga e cila përfitoi vetëm Fakulteti i Mjekësisë.<sup>84</sup>

<sup>83</sup> KRPP “Njoftim”, gusht 2015 <https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=1&CtID=VieëNotices&ID=104156>

<sup>84</sup> Artikulli “Kontrata milionëshe – përfitues vetëm fakulteti i mjekësisë”, shkurt 2015 <http://kallxo.com/gjnk/kontrata-milioneshe-perfitues-vetem-fakulteti-i-mjekesise/>

<sup>82</sup> Agjencia Qendrore e Prokurimit <https://aqp.rks-gov.net/sq/rreth-aqp-se>

Nga kjo kontratë ishte paraparë që libra shkencorë të përfitonin edhe fakultetet e tjera por një gjë e tillë nuk ndodhi.

Madje fakultetet tjera si ai i Ekonomisë, Filologjisë as që kishin bërë ndonjëherë kërkesa për furnizim me libra shkencorë, përderisa Fakulteti i Edukatës Fizike as që ishte në dijeni për një kontratë të tillë.

Kontrata e dyshimtë, e negocuar pa publikim nga UP-ja dhe MASHT-i për furnizim me libra shkencorë është inicuar në vitin 2012 kur rektor ishte Mujë Rugova.<sup>85</sup>

Një tjetër hulumtim i gazetës JNK, në shkurt të vitit 2015 tregoi se UP ka vazhduar me keqpërdorimin e buxhetit për materialin harxhues zyrtar, i blerë me çmime më të shtrenjta se sa çmimi i tregut.<sup>86</sup>

Për një marker që në treg kushton 0.40 cent, UP-ja dy vjet me radhë pagoi 1.5 euro. Gjithashtu, për 500 fletë të formatit A4, të cilat në treg mund të blihen me 2.7 euro, UP-ja pagoi 3.98 euro apo gati dyfishin e shumës së tregut.

Në anën tjetër, parregullsitë e tenderit dhe fryrja e çmimeve të materialit harxhues që shpenzohet vazhdimisht, krahas uljes së çmimit deri në praktikisht 'zero' për materiale që nuk porositen asnjëherë nga UP-ja, dëshmohej edhe nga fakti që 250 fletë të formatit A3 të cilat në treg kushtojnë 20 euro, UP-së iu ofruan nga kompania me 0.009 cent.

Edhe kjo kontratë ishte nënshkruar në vitin 2012 për dy vite, e vlefshme deri në vitin 2014 në kohën sa ishte rektorë Mujë Rugova,

Një "përshtatje" e tillë e çmimeve ka ndodhur vazhdimisht jo vetëm nga UP-ja por edhe nga institucione tjera.

85 Artikulli "Nënshkrim i dyshimtë në kontratën 3.3 milionëshe", shkurt 2015 <http://kallxo.com/gjnk/nenshkrimi-i-dyshimte-ne-kontraten-3-3-milioneshe/>

86 Artikulli "Kontrata e UP-së me çmime të manipuluar", shkurt 2015 <http://kallxo.com/gjnk/kontrata-e-up-se-me-çmime-te-manipuluar/>

Në një sërë rastesh, kompania e shpërbyler me tender me çmimin më të lirë, realisht nuk ka qenë më e lira, por vlera totale e ofertës në fund ka rezultuar të jetë më e lira pikërisht për shkak të futjes së çmimit më të lartë se vlera e tregut për mallin që harxhohet më shumë, duke zvogëluar apo nënvlerësuar çmimin e materialit që nuk porositet fare. Ky është një truk për të cilin monitorimi jonë ka gjetur që janë bashkëpunues autoritetet kontaktuese bashkë me kompanitë që i fitojnë marrin kontratat, gjë që bëhet e mundur përmes uljes së disa çmimeve dhe fryrjes së çmimeve ku buxheti i Kosovës dëmtohet më së shumti.

Një tjetër aktakuzë u ngrit në korrik të vitit 2015 ndaj Enver Hasanit sa ishte rektor i Universiteti të Prishtinës.

Sipas aktakuzës së prokurorisë, Hasani në cilësinë e rektorit të UP-së, Hakif Veliu si shef i Zyrës së Prokurimit në UP dhe Albert Rakipi si drejtor i Institutit për Studime Ndërkombëtare (ISN), si persona zyrtarë dyshohet se kanë falsifikuar kontratën origjinale "Përkthimi i Librave nga Gjuha Angleze në Gjuhën Shqipe për Nevojat e Universitetit të Prishtinës" të datës 5 dhjetor 2008.<sup>87</sup>

Vlera e kontratës për të cilën akuzohet Enver Hasani është gjysmë milioni euro, ndërsa aktakuza i ngarkon të pandehurit se, sipas marrëveshjes paraprake, kanë lidhur një kontratë të re në të cilën kanë shfrytëzuar numrin e njëjtë të protokollit dhe datën e njëjtë të kontratës origjinale duke ndryshuar nenin 17 të kontratës, ashtu që në vend të çmimit për njësi-1000 fjalë 12.65 euro, kanë shënuar çmimin për njësi -1000 karaktere 12.65 euro.

Në aktakuzë pretendohet se ky ndryshim çmimi i ka mundësuar përfitim më të madh Institutit për Studime Ndërkombëtare e që është përgjegjës Enver Hasani me zyrtarët tjerë të UP-së

87 Artikulli "Ekspertizë e re ndaj rastit gjyqsor të Enver Hasanit, qershorë 2016 <http://kallxo.com/ekspertize-e-re-ne-rastin-gjyqsor-ndaj-enver-hasanit/>

# NDËRMARRJET PUBLIKE

Në Ndërmarrjet Publike qendrore dhe regjionale përfshihen 33 Autoritete Kontraktuese me gjithsej 2.681 njoftime të publikuara.

a) Tabela e mëposhtme paraqet kategorinë e njoftimeve të publikuara për periudhën janar-dhjetor 2015.

	Numri
Njoftim Kontrate	1,116 42%
Njoftim per dhenie te kontrates	1,096 41%
Njoftim anulimi	395 15%
Njoftim paraprak	9 0.34%
Njoftim mbi rezultatin e konkursit	2 0.07%
Njoftim mbi konkurs Projektimin	4 0.15%
Njoftim i anulimit te kontrates	29 1%
Njoftim per informata shtese ose permiresim i gabimit	30 1%
<b>TOTAL</b>	<b>2,681</b> <b>100%</b>

b) Prej 1.116 njoftimeve për kontratë, 395 apo 35% e njoftimeve janë anuluar para dhënies së kontratës sipas tabelës së mëposhtme

Anulimet	Numri
Ne mungese te ofertave te pergjegjshme	198 50%
Opinion te AKK	2 1%
Tejkalim substancial i buxhetit	45 11%
Te dhena te pamjaftueshme	85 22%
Te tjera	55 14%
OSHP	10 3%
<b>TOTAL</b>	<b>395</b> <b>100%</b>



## c) Tabela e mëposhtme pasqyron numrin dhe vlerën e njoftimit për dhënien e kontratave

	Vlera e kontratave	Numri, Shuma
Të mëdha	Të mëdha	115 10%
	Shuma e kontratave të mëdha	97,971,422 82%
Të mesme	Të mesme	423 39%
	Shuma e kontratave të mesme	18,654,372 16%
Të vogla	Të vogla	558 51%
	Shuma e kontratave të vogla	2,774,415 2%
	Total kontrata në numër	Total kontrata në vlerë
	1,096	119,400,209
	100%	100%

Ndërmarrjet Publike gjatë vitit 2015 nga totali i njoftimeve të kësaj kategorie, kanë anuluar gjysmën e njoftimeve para nënshkrimit të kontratave apo 50% të tyre me arsyen se nuk ka oferta të përgjegjshme. Kjo kategori e arsyes së dhënë është rritur krahasuar me vitin 2014 kur ishin 37%. Rreth 22% e anulimeve të përgjithshme ishin pa evidentim të arsyeve konkrete të anulimit – shifër kjo që paraqet rritje krahasuar me vitin 2014 gjatë të cilit vit 9% e anulimeve ishin pa arsye konkrete.

Ndërsa kategoria e anulimeve tjera ku njoftimet para hapjes së ofertave anulohen për shkak gabimeve teknike të AK, pësoi një rënie nga viti i kaluar, përkatësisht nga 36% sa ishin në vitin 2014u ul në nivelin 14% në vitin 2015

Nga gjithsej 5 opinione të cilat i lëshoi AKK-ja për Ndërmarrjet Publike,aktivitetet e prokurimit

i anuluan vetëm 2 ndërmarrje si KOSST-i<sup>88</sup> dhe Kompania Rajonale e Ujësjellësit Mitrovica<sup>89</sup>, ndërsa aktivitetet e prokurimit duke u bazuar në opinionet e AKK-së nuk i deklaruan se i anuluan PTK-ja<sup>90</sup>, Trainkos-i<sup>91</sup> dhe Infrakos-i<sup>92</sup> pavarësisht që edhe për këto Ndërmarrje Publike kishte një opinionon ngaAKK-ja.

88 Agjencia kundër korrupsionit "Opinion për KOSTT", shkurt 2015 <http://www.akk-ks.org/repository/docs/opinion-%20KOSTT-dpkpp.pdf>

89 Agjencia kundër korrupsionit "Opinion për KUR Mitrovica", shkurt 2015 <http://www.akk-ks.org/repository/docs/opinion-%20KUR-Mitrovica-dpkpp.pdf>

90 Agjencia kundër korrupsionit "Opinion për Postën e Kosovës", korrik 2015 [http://www.akk-ks.org/repository/docs/opinion\\_Posta\\_e\\_Kosoves-dpkpp\\_313964.pdf](http://www.akk-ks.org/repository/docs/opinion_Posta_e_Kosoves-dpkpp_313964.pdf)

91 Agjencia kundër korrupsionit "Opinion për Trainkos", maj 2015 <http://www.akk-ks.org/repository/docs/01-1297-2015.pdf>

92 Agjencia kundër korrupsionit "Opinion për Infrakos", tetor 2015 [http://www.akk-ks.org/repository/docs/01-3642-15-opinion\\_dpkpp-Infrakos\\_467699.pdf](http://www.akk-ks.org/repository/docs/01-3642-15-opinion_dpkpp-Infrakos_467699.pdf)


Në uebfaqen e KRPP-së, Ndërmarrjet Publike kanë të publikuara më së shumti kontrata të vogla me kuotim me pjesëmarrje prej 558 kontrata apo 51%, pasuar nga 423 kontratat të mesme apo 39%, kurse të publikuara kanë vetëm 115 kontrata të mëdha apo 10%.

Te Ndërmarrjet Publike për nga vlera prijnë kontratat e mëdha në vlerë prej 98 milionë euro apo 82%, pasuar nga kontrata e mesme me 18.7 milionë euro apo 16%, ndërsa kontratat e vogla edhe pse ishin të parat në

numër në vlerë monetare janë të fundit me pjesëmarrje prej 2.7 milionë euro apo 2%.

Krahasuar me vitin 2014, Ndërmarrjet Publike nuk kanë reflektuar ndryshime në numrin e dhënies së kontratave por vlera e tyre ka pësuar rënie për 20%.

Kjo do të thotë se nga 149 milionë euro sa ishin publikuar në vitin 2014 vlera e tyre u zvogëlua në 119.4 milionë euro në vitin 2015.



Këtë e dëshmon vetë Ministria e Zhvillimit Ekonomik me publikimin e raporteve financiare të vitit 2014 për Ndërmarrjet Publike.

Në raport thuhet se nga gjithsej 17 ndërmarrje, dhjetë prej tyre kanë pasur bilanc pozitiv, ndërsa 7 ndërmarrje tjera vazhdojnë ta përmbyllin vitin me humbje financiare. Nga këndvështrimi individual për secilën ndërmarrje, tri prej tyre kanë rritur fitimin: KOSTT, Kompania Regjionale e Ujësjetësimit "Mitrovica" dhe Kompania e Ujësjetësimit "Prishtina".

Në anën tjetër, kompanitë të cilat kanë operuar me humbje janë Hidroregjioni Jugor-Prizren si dhe Hidrodrini- Pejë. Aeroporti "Adem Jashari" i ka evituar humbjet e mëhershme, ndërkaq fitimet i kanë zvogëluar KEK-u dhe Posta e Kosovës, ndërsa humbjet i kanë rritur edhe Ibër- Lepenci dhe Ujësjetësi Radoniqi- Gjakovë<sup>93</sup>

93 Artikulli "Performancë e Dobët e Ndërmarrjeve Publike", janar 2016 <http://kallxo.com/performance-e-dobet-e-ndermarrjeve-publike/>

Nr	Ndërmarrja publike	Fitim	Humbje	Zvoglim i fitimit
1	KOSTT	✓		
2	KRU Mitrovica	✓		
3	KRU Prishtina	✓		
4	Hidroregjioni Jugor- Prizren		✓	
5	Hidrodrini- Pejë		✓	
6	KEK			✓
7	Posta e Kosovës			✓
8	Ibër- Lepenci			✓
9	Ujësjiellësi Radoniqi- Gjakovë			✓

Gazeta Jeta në Kosovë zbuloi një tjetër tender të dyshimtë, kur edhe përkundër akuzave për ryshfet në Rumani dhe një falimentim të dyshimtë në Serbi, kompania “Mineco” nënshkroi kontratë multimilionëshe me ndërmarrjen Trepça-Veri, me seli në Zveçan.

Kontrata e cila varion prej 15 deri në 20 milionë euro u lidh me “Mineco” pavarësisht që kjo e fundit në vitin 2013 kishte ngritur padi duke pretenduar se është dëmtuar nga Trepça-Veri, në një kontratë të mëhershme të furnizimit me koncentrat të plumbit. Mirëpo marrëveshja e nënshkruar më 15 Maj 2015 parasheh që “Mineco” të ndërpresë përkohësisht kërkesën për ekzekutim që i është bërë autoriteteve gjyqësore në Kosovë.

Anëtari i bordit të kompanisë “Mineco”, Dimitrije Aksentijevic, akuzohet për korrupsion në Rumani, e gjithashtu edhe drejtuesit e kësaj kompanie u gjykuan në mungesë nga gjykata në Rumani<sup>94</sup> Gazeta JnK në një tjetër hulumtim zbuloi se buxheti i Kosovës mund të humbasë 180 deri në 500 milionë euro nga kompania gjermane “ACP Axos Kapital”, e cila në qershor 2015 ka paditur Postën dhe Telekomin e Kosovës (PTK) në Gjykatën e Arbitrazhit në Uashington për tenderin e vitit 2013, kur qeveria e asaj kishte miratuar shitjen e 75% të aksioneve në VALA e Telekom.

Kompania “Axos” ka kërkuar kompensim nga qeveria e Kosovës, sepse një kohë të gjatë është përgatitur për pjesëmarrje në procesin e aplikimit për blerjen e aksioneve, duke pretenduar se ka shpenzuar mjaft para për procesin e dështuar të privatizimit të PTK-së.<sup>95</sup>

Pavarësisht se qeveria po hesht dhe po e mban të fshehur akuzën nga “Axos”, PTK-ja më 8 qershor 2015 kontraktoi kompaninë zvicerane “Homburger AG” në vlerë prej 6 mijë euro për “Kryerjen e Ekspertizës Legale për Arbitrazhin në ICC”.<sup>96</sup> BIRN kontaktoi zyrtarë të PTK-së për

94 Artikulli “Të dyshuarit për ryshfet fitojnë milionat në Trepçë”, gusht 2015 <http://kallxo.com/gjnk/te-dyshuarit-per-ryshfet-fitojne-milionat-ne-trepce/>

95 Artikulli “Axos – rreziku qindra milionësh”, shtator 2015 <http://kallxo.com/gjnk/axos-rreziku-qindra-milionesh/>

96 KRPP “Njoftim”, qershor 2015 <https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=VieëNotices&ID=99841>

tenderin e kontraktuar të ekspertizës, por nuk mori përgjigje.

Mungesën e transparencës lidhur me përgatitjet e qeverisë së Kosovës për t’u mbrojtur nga një humbje eventuale e parave publike në arbitrazh janë duke ushqyer dyshimet e disa të cilët po tërheqin vëmendjen që individë të caktuar në pushtet janë të interesuar që Kosova ta humbë këtë rast në arbitrazh në mënyrë që, ata që ashtukështu e inicuan privatizimin e PTK-së pa kaluar në procedura të duhura për blerjen e një ndërmarreje kaq të rëndësishme publike, të përfitojnë ryshfet nga kompenzimi sa më i madh që do pagujë qeveria e Kosovës për AXOS, kompani me bazë në ishujt....

Pas një viti Ministri Blerand Stavileci në një konferencë ku u bë publikimi i raportit për PTK-në nga organizata “Çohu” për herë të parë bëri publike paditë ndaj PTK-së, ku theksoi se në gusht 2016 do të mbahet një seancë gjykimi. Sipas Stavilecit, kërkesat e kompanive paditëse shkojnë nga 150 deri në 600 milion euro<sup>97</sup>

97 Artukulli “‘Çohu’:PTK-ja problem me të hyrat dhe paditë”, maj 2016 <http://kallxo.com/cohu-ptk-ja-probleme-te-hyrat-dhe-padite/>

# MINISTRITË

Në kuadër të ministrive përfshihen 19 Autoritete Kontraktuese, me gjithsej 1,486 njoftime sipas tabelës së mëposhtme:

	Numri
Njoftim Kontrate	538 36%
Njoftim per dhenie te kontrates	637 43%
Njoftim anulimi	244 16%
Njoftim paraprak	4 0.27%
Njoftim mbi rezultatin e konkursit	1 0.07%
Njoftim mbi konkurs Projektimin	5 0.34%
Njoftim konkurs projektimi -Hapja e Ofertave financiare	4 0.27%
Njoftim i anulimit te kontrates	26 2%
Njoftim per informata shtese ose permiresim i gabimit	27 2%
<b>TOTAL</b>	<b>1,486</b> <b>100%</b>

Krahasuar me vitin 2014, Ministrinë kanë 30% apo 655 njoftime më pak në vitin 2015. Nga 2,141 sa ishin publikuar në vitin 2014, viti 2015 i gjen Ministrinë me 1,486 njoftime

Anulimet para dhënies së kontratave janë bërë sipas arsyeve të mëposhtme:

Anulimet	Numri
Ne mungese te ofertave te pergjegjshme	115 47%
Opinion te AKK	3 1%
Tejkalim substancial i buxhetit	19 8%
Te dhena te pamjaftueshme	62 25%
Te tjera	37 15%
OSHP	8 3%
<b>TOTAL</b>	<b>244</b> <b>100%</b>

Krahasuar me vitin 2014 kur nuk kishte anulime me mungesë të dhënash, në vitin 2015 kësaj kategorie iu shtuan 25% apo 62 anulime para dhënies.

Anulimet më të shumta kanë përshkrimin në mungesë të ofertave të përgjegjshme me pjesëmarrje prej 115 anulime apo 47% nga totali i 244 anulimeve para dhënies së tenderëve.

Në vitin 2014 Ministrinë nuk kanë anuluar njoftime për kontrata për shkak të opinionit të AKK-së, megjithatë as gjatë vitit 2015 Ministrinë nuk i morën me seriozitet opinionet e AKK-së për të anuluar aktivitetet e prokurimit edhe pse kjo e fundit publikoi 22 opinione për ministrinë.

E vetmja, Ministria e Financave<sup>98 99 100</sup> anuloi 4 njoftime para dhënies së kontratave duke u bazuar në rekomandimet të AKK-së, kurse 18 opinione tjera drejtuar Ministrisë së Drejtësisë në tri raste<sup>101 102 103</sup>, Ministrisë së Infrastrukturës në një rast<sup>104</sup>, Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik në dy raste<sup>105 106</sup>,

98 Agjencia kundër korrupsionit "Opinion për Ministrinë e Financave", shtator 2015 [http://www.akk-ks.org/repository/docs/opinion\\_dpkkp-Ministria\\_e\\_Fianancave\\_575203.pdf](http://www.akk-ks.org/repository/docs/opinion_dpkkp-Ministria_e_Fianancave_575203.pdf)

99 Agjencia kundër korrupsionit "Opinion për Ministrinë e Financave", shtator 2015 [http://www.akk-ks.org/repository/docs/opinion\\_dpkkp-MF\\_308458.pdf](http://www.akk-ks.org/repository/docs/opinion_dpkkp-MF_308458.pdf)

100 Agjencia kundër korrupsionit "Opinion për Ministrinë e Financave", shtator 2015 [http://www.akk-ks.org/repository/docs/opinion-dpkpp-MF\\_1\\_902826.pdf](http://www.akk-ks.org/repository/docs/opinion-dpkpp-MF_1_902826.pdf)

101 Agjencia kundër korrupsionit "Opinion për Infrakos", tetor 2015 [http://www.akk-ks.org/repository/docs/01-3642-15-opinion\\_dpkkp-Infrakos\\_467699.pdf](http://www.akk-ks.org/repository/docs/01-3642-15-opinion_dpkkp-Infrakos_467699.pdf)

102 Agjencia kundër korrupsionit "Opinion për Ministrinë e Drejtësisë", korrik 2015 [http://www.akk-ks.org/repository/docs/opinion\\_M.Drejtësisë\\_24584.pdf](http://www.akk-ks.org/repository/docs/opinion_M.Drejtësisë_24584.pdf)

103 Agjencia kundër korrupsionit "Opinion për Ministrinë e Drejtësisë", maj 2015 <http://www.akk-ks.org/repository/docs/01-1307-2015.pdf>

104 Agjencia kundër korrupsionit "Opinion për Ministrinë e Infrastrukturës", nëntor 2015 [http://www.akk-ks.org/repository/docs/OPINION\\_DPKPP-M.INFRASTRUKTURES\\_0911201512455400\\_827238.pdf](http://www.akk-ks.org/repository/docs/OPINION_DPKPP-M.INFRASTRUKTURES_0911201512455400_827238.pdf)

105 Agjencia kundër korrupsionit "Opinion për Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik", shtator 2015 [http://www.akk-ks.org/repository/docs/01-2904-15-dpkpp-Opinion\\_MZHE\\_216069.pdf](http://www.akk-ks.org/repository/docs/01-2904-15-dpkpp-Opinion_MZHE_216069.pdf)

106 Agjencia kundër korrupsionit "Opinion për Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik", mars 2015 <http://www.akk-ks.org/repository/docs/opinion%20MZHE-dpkpp.pdf>

Ministrisë së Shëndetësisë<sup>107</sup>, në katër raste<sup>108 109 110</sup>, Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit në tri raste<sup>111 112 113</sup>, Ministrisë së Administratës Publike në një rast<sup>114</sup>, Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë në dy raste<sup>115 116</sup>, Ministrisë së Forcës dhe Sigurisë në një rast<sup>117</sup>, dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme në një rast<sup>118</sup> nuk u deklaruan në formularët standardë se morën për bazë opinionet e AKK-së për të anuluar aktivitetet e prokurimit.

Tabela e mëposhtme paraqet numrin e njoftimeve për dhënie të kontratave sipas vlerave të tyre:

107 Agjencia kundër korrupsionit "Opinion për Ministrinë e Shëndetësisë", shtator 2015 [http://www.akk-ks.org/repository/docs/01-2756-15\\_1409201514105700\\_834188.pdf](http://www.akk-ks.org/repository/docs/01-2756-15_1409201514105700_834188.pdf)

108 Agjencia kundër korrupsionit "Opinion për Ministrinë e Shëndetësisë", gusht 2015 [http://www.akk-ks.org/repository/docs/01-2534-15\\_383256.pdf](http://www.akk-ks.org/repository/docs/01-2534-15_383256.pdf)

109 Agjencia kundër korrupsionit "Opinion për Ministrinë e Shëndetësisë", gusht 2015 [http://www.akk-ks.org/repository/docs/01-2533-15\\_380698.pdf](http://www.akk-ks.org/repository/docs/01-2533-15_380698.pdf)

110 Agjencia kundër korrupsionit "Opinion për Ministrinë e Shëndetësisë", shkurt 2015 <http://www.akk-ks.org/repository/docs/opinionMinistria%20e%20Shendetësisë%2016%20shkurt%202015.pdf>

111 Agjencia kundër korrupsionit "Opinion për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve", gusht 2015 [http://www.akk-ks.org/repository/docs/opinion\\_dpkkp-MKRS\\_922941.pdf](http://www.akk-ks.org/repository/docs/opinion_dpkkp-MKRS_922941.pdf)

112 Agjencia kundër korrupsionit "Opinion për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve", mars 2015 [http://www.akk-ks.org/repository/docs/opinion%20MKRS-dpkpp\\_1103201511125600.pdf](http://www.akk-ks.org/repository/docs/opinion%20MKRS-dpkpp_1103201511125600.pdf)

113 Agjencia kundër korrupsionit "Opinion për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve", shkurt 2015 <http://www.akk-ks.org/repository/docs/opinion%20MKRS-dpkpp.pdf>

114 Agjencia kundër korrupsionit "Opinion për Ministrinë e Administrimit Publik", korrik 2015 [http://www.akk-ks.org/repository/docs/opinion\\_dpkkp-MAP\\_737762.pdf](http://www.akk-ks.org/repository/docs/opinion_dpkkp-MAP_737762.pdf)

115 Agjencia kundër korrupsionit "Opinion për Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë", korrik 2015 [http://www.akk-ks.org/repository/docs/opinion\\_dpkkp-MTI\\_259766.pdf](http://www.akk-ks.org/repository/docs/opinion_dpkkp-MTI_259766.pdf)

116 Agjencia kundër korrupsionit "Opinion për Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë", mars 2015 <http://www.akk-ks.org/repository/docs/opinion-MTI-dpkpp.pdf>

117 Agjencia kundër korrupsionit "Opinion për Ministrinë e Forcës të Sigurisë së Kosovës", prill 2015 <http://www.akk-ks.org/repository/docs/opinion-MFSK-dpkpp.pdf>

118 Agjencia kundër korrupsionit "Opinion për Punë të Brendshme", prill 2015 <http://www.akk-ks.org/repository/docs/opinion-MPB-dpkpp.pdf>

	Vlera e kontratave	Numri, Shuma
Të mëdha	Të mëdha	105 16%
	Shuma e kontratave të mëdha	55,300,283 78%
Të mesme	Të mesme	223 35%
	Shuma e kontratave të mesme	13,431,558 19%
Të vogla	Të vogla	309 49%
	Shuma e kontratave të vogla	2,020,264 3%
	Total kontrata në numër	Total kontrata në vlerë
	637 100%	70,752,106 100%

Nga gjithsej 637 kontrata me vlerë prej 70.7 milionë euro kontratat klasifikohen sipas kësaj renditjeje:

- 1) Sipas numrit prijnë kontratat e vogla me pjesëmarrje prej prej 49%, përderisa për nga vlera këto kontrata klasifikohen të fundit me pjesëmarrje prej vetëm 3% apo 2 milionë euro vlerë monetare.
- 2) Në numër pasojnë kontratat e mesme me pjesëmarrje prej 35% apo 223 kontrata por për nga vlera kanë pjesëmarrje prej 19% apo 13.4 milionë euro;
- 3) Ndërsa me më së paku pjesëmarrje, prej 16%, janë kontratat e mëdha por megjithatë kjo kategori e kontratave ka vlerë më të madhe se dy kategoritëe lartpërmendura me pjesëmarrje prej 78% apo 55.3 milionë euro vlerë monetare.

Nga viti 2014 vlera e kontratave të publikuara nga Ministrinë ka rënie për 91%, nga 745.5 milionë euro sa ishte vlera e kontratave në vitin 2014 kjo vlerë në vitin 2015 arrin në 70.7 milionë euro.

Arsyeja pse ka ndodhur kjo rënie është se në vitin 2014 ishte kontraktuar autostrada 600 milionë euro që lidh Kosovën me Maqedoninë, e cila sipas planit dinamik duhet të përfundojë në fillim të vitit 2018.

Sikurse te komunat po ashtu edhe te Ministrinë auditori ka identifikuar mos menaxhim të mirë të parasë publike siç janë pagesat e shërbimeve pa u kryer puna siç ka ndodhur në Ministrinë e Kulturës<sup>119</sup>. Pagesa për punë shtesë pa planifikim të mirë të prokurimit ka pasur te Ministria e Arsimit<sup>120</sup>, dhe te Ministria e Financave<sup>121</sup>.

119 Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, "Raporti i auditimit për pasqyrat financiare të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014", qershor 2015 [http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit\\_MKRS\\_2014\\_Shqip\\_853422.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_MKRS_2014_Shqip_853422.pdf)

120 Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, "Raporti i auditimit për pasqyrat financiare të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014", qershor 2015 [http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit\\_MASHT\\_2014\\_Shqip\\_696850.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_MASHT_2014_Shqip_696850.pdf)

121 Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, "Raporti i auditimit për pasqyrat financiare të Ministrisë së Financave për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014", qershor 2015 [http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit\\_MF\\_2014\\_Shqip\\_511139.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_MF_2014_Shqip_511139.pdf)

Vonesat në kryerjen e punëve sipas kushteve të kontratës janë një fenomen që tash e sa vite nuk janë evituar, dhe raste të ngjashme Auditori Gjeneral ka evidentuar në disa Ministri të cilat nuk janë kryer punët sipas planit dinamik si të Ministria e Kulturës<sup>122</sup>, Ministria e Financave<sup>123</sup>. Ministria e Planifikimit Hapësinor<sup>124</sup> dhe Ministria e Punëve të Brendshme<sup>125</sup>

Lidhja e kontratave pa procedura të prokurimit sipas raporteve të auditorit evidenton shkelje të disa Ministri si të Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit<sup>126</sup>, Ministria e Arsimit<sup>127</sup> dhe Ministria e Tregtisë dhe Industrisë<sup>128</sup>

Pa proces të hapur të prokurimit duke e eliminuar konkurrencën auditori ka evidentuar shkelje të Ministria e Zhvillimit Ekonomik kur kishte blerë aparate telefonikë nga IPKO<sup>129</sup>,

122 Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, "Raporti i auditimit për pasqyrat financiare të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014", qershor 2015 [http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit\\_MKRS\\_2014\\_Shqip\\_853422.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_MKRS_2014_Shqip_853422.pdf)

123 Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, "Raporti i auditimit për pasqyrat financiare të Ministrisë së Financave për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014", qershor 2015 [http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit\\_MF\\_2014\\_Shqip\\_511139.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_MF_2014_Shqip_511139.pdf)

124 Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, "Raporti i auditimit për pasqyrat financiare të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014", qershor 2015 [http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit\\_MMPH\\_2014\\_Shqip\\_112953.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_MMPH_2014_Shqip_112953.pdf)

125 Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, "Raporti i auditimit për pasqyrat financiare të Ministrisë së Punëve të Brendshme për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014", qershor 2015 [http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit\\_MPB\\_2014\\_Shqip\\_745585.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_MPB_2014_Shqip_745585.pdf)

126 Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, "Raporti i auditimit për pasqyrat financiare të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014", qershor 2015 [http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit\\_MKRS\\_2014\\_Shqip\\_853422.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_MKRS_2014_Shqip_853422.pdf)

127 Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, "Raporti i auditimit për pasqyrat financiare të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014", qershor 2015 [http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit\\_MASHT\\_2014\\_Shqip\\_696850.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_MASHT_2014_Shqip_696850.pdf)

128 Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, "Raporti i auditimit për pasqyrat financiare të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014", qershor 2015 [http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit\\_MTI\\_2014\\_Shqip\\_807196.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_MTI_2014_Shqip_807196.pdf)

129 Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, "Raporti i auditimit për pasqyrat financiare të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014", qershor 2015 [http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit\\_MZHE\\_2014\\_Shqip\\_611343.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_MZHE_2014_Shqip_611343.pdf)

ndërsa shmangie të procedurave të prokurimit duke i ikur procedurave të hapura dhe duke i ndarë kontratat në tenderë të vegjël ka aplikuar Ministria e Arsimit<sup>130</sup>, Ministria e Financave<sup>131</sup> dhe Ministria e Punëve të Jashtme<sup>132</sup>.

\*\*\*

Në vitin 2015, OSHP-ja anuloi licencën e prokurimit menaxheres së Prokurimit në Ministrinë e Financave. Elmaze Xhema, nga Organi Shqyrtues i Prokurimit akuzohej për shkeljet të rënda të Ligjit të Prokurimit Publik pasi ajo nuk kishte respektuar vendimin e OSHP-së për pezullimin automatik të një aktiviteti të prokurimit.

Paneli Shqyrtues i OSHP-së kishte urdhëruar Ministrinë e Financave të pezullojë aktivitetin e prokurimit me titullin "Shërbime të sigurimit të automjeteve", Elmaze Xhema nuk e kishte respektuar këtë vendim andaj iu kishte anuluar licenca.<sup>133</sup>

BIRN intervistoi Elmaze Xhemën lidhur me anulimin e lincencës në fjalë, e cila për Gazetën Jeta në Kosovë theksoi se problemi ka lindur për shkak vonesës së e-mailit dërguar OSHP-së

"Unë e kam respektuar vendimin e OSHP-së, e kam pezulluar atë aktivitetet të prokurimit, vetëm se OSHP-së nuk ia kam kthyer me kohë e-mailin dhe ata kanë menduar se nuk e kam respektuar vendimin", tha Xhema.<sup>134</sup>

130 Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, "Raporti i auditimit për pasqyrat financiare të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014", qershor 2015 [http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit\\_MASHT\\_2014\\_Shqip\\_696850.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_MASHT_2014_Shqip_696850.pdf)

131 Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, "Raporti i auditimit për pasqyrat financiare të Ministrisë së Financave për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014", qershor 2015 [http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit\\_MF\\_2014\\_Shqip\\_511139.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_MF_2014_Shqip_511139.pdf)

132 Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, "Raporti i auditimit për pasqyrat financiare të Ministrisë së Punëve të Jashtme për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014", qershor 2015 [http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit\\_MPJ\\_2014\\_Shqip\\_662328.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_MPJ_2014_Shqip_662328.pdf)

133 Organi Shqyrtues i Shërbimet për sigurimin e veturave TPL, TPL + dhe sigurimi Kasko, dhjetorë 2015 [https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2015/414-15\\_vendim\\_MF\\_3\\_1.PDF](https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2015/414-15_vendim_MF_3_1.PDF)

134 Intervistë me Elmaze Xhemën – Prishtinë 15 shkurt 2016



Xhema po ashtu potencoi se edhe Sekretari i MF-së ka bërë parashtrësë kundër këtij vendimi në OShP, por ende nuk kanë marrë përgjigje. Ndërsa znj. Xhema ka shkuar më tej duke paraqitur edhe ankesë në gjykatë.

Kjo nuk është hera e parë që OSHP-ja anulon licencat e prokurimit për zyrtarët e prokurimit. Në vitin 2012 licenca iu anulua Bekim Gojanit, menaxherit të prokurimit nga Ministria e Infrastrukturës, për shkelje ligjore të ligjit të prokurimit dhe diskriminimin e operatorëve ekonomik për gjashtë aktivitetete të prokurimit, përveq marrjes së licencës edhe Ministria e Infrastrukturës ishte gjobitur me 10 mijës euro.<sup>135</sup>

Në vitin 2014 licenca e prokurimit iu anulua edhe Suzana Kosumit, menaxheres së prokurimit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, për tenderin “Ndërtimi i Stacionit Policor, faza e dytë në Kllokot”. MAPL me faj të vetin nuk i kishte zhvilluar procedurat e prokurimit me kohë, me ç’rast kompanive iu kishte skaduar vlefshmëria e ofertës, poashtu për këtë tender MAPL-ja ishte gjobitur me 20 mijë euro.<sup>136</sup>

Në vitin 2015 licenca iu anulua edhe menaxherit të Prokurimit nga PTK-ja Fatmir Gjonbalaj, PTK-ja po ashtu u gjobit me 30 mijë euro për moszbatim të vendimit të OShP-së për tenderin

“Punë dhe furnizim për zgjerimin e rrjetit të telekomunikues në Kosovë”<sup>137</sup>

135 Organi Shqyrtues i Prokurimit, mbi anulimin e licences se prokurimit z. Bekim Gojani u.d. Drejtor i Departamentit te Prokurimit, si dhe shqiptimin e gjobes, shkurt 2012 [https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2012/Sinjal\\_sanim\\_Kline-broje.pdf](https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2012/Sinjal_sanim_Kline-broje.pdf)

136 Organi Shqyrtues i Prokurimit, Ndërtimi i Stacionit Policor- faza e dytë në Kllokot, prill 2014 <https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2014/44-14-vend.pdf>

137 Organi Shqyrtues i Prokurimit, Vendim mbi anulimin e licensës së prokurimit dhe shqiptimin e gjobës, PTK, prill 2015 <https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2015/58-72-519-15-vend-ptk.pdf>

Paneli Shqyrtues i OShP kishte rekomanduar që Post Telekom i Kosovë të pezullojë komplet aktivitetin e prokurimit me titullin “Punë dhe furnizim për zgjerimin e rrjetit të telekomunikues në Kosovë”, Fatmir Gjonbalaj nuk e kishte respektuar vendimin andaj i ishte marrë licenca e prokurimit.

Ndërrarja tjetër Publike KEK poashtu në vitin 2015 u gjobit me 30 mijë euro, licenca iu anulua menaxherit të prokurimit të kësaj ndërmarrje Ymer Dragushës, për moszbatimin e vendimit të OSHP-së<sup>138</sup>

Paneli shqyrtues i OShP-së kishte rekomanduar që tenderi i Korporatës Energjetike të Kosoves (KEK)! me titull “Furnizim me material per tambura veprues lot.6” është dasht të shkojë në ri-vlersim, Ymer Dragusha nuk e kishte respektuar këtë vendim andaj OShP kishte marrë vendimin e anulimit të licencës.

\*\*\*

Gazeta Jeta në Kosovë gjatë vitit 2015 kishte hulumtuar një zyrtarë nga Ministria e Infrastrukturës i cili kishte marrë detyrën që të jetë në komision vlerësues për tenderin “Mirëmbajtja verore dhe dimorore e autostradës” Ibrahim Rugova”.

Fjala është për zyrtarin Bekim Gojanin i cili para se të vlersojë një tender sipas ligjit të prokurimit publik duhet të nënshkruajë deklaratë nën betim e cila i detyron zyrtarët e prokurimit t’i respektojnë rregullat, të mbrojnë nga zbulimi dhe të ruajnë konfidencialitetin e informacioneve afariste. Gjatë kohës sa tenderi ishte në vlerësim, Bekim Gojani si anëtar i komisionit vlerësues për tenderin e mirëmbajtjes verore dhe dimorore të autostradës “Ibrahim Rugova” me vlerë prej 1.2 milion euro, ishte takuar me pronarin e kompanisë “Famis CO<sup>138</sup>, Bekim Bytyçin, kompani kjo e cila pas dy ditëve u shpall fituese e këtij tenderi.

138 Artikulli “Takimi i ‘mistershëm’ i zyrtarit shtetëror me biznesmenin”, nëntor 2015 <http://kallxo.com/gjnk/takimi-i-mistershem-i-zyrtarit-shteteror-me-biznesmenin/>

Ligji i prokurimit ndalon anëtarët e komisioneve vlerësuese që të takojnë përfaqësuesit e firmave konkurrenente në tenderë e aq më pak në fazën e vlerësimit. Pas shpalljes fitues të “Famis CO” për tenderin në fjalë, OShP-ja kishte anuluar tenderin për shkak se kompania ishte e papërgjegjshme.

Bekim Gojani, të cilit në vitin 2012 i ishte marrë licenca e prokurimit, në vitin 2015 u certifikua prapë me licencë si zyrtar i prokurimit. Ligji i LPP-së nuk e parasheh pas sa viti një zyrtari të prokurimit mund t'i rikthehet licenca.

## AGJENCITË E PAVARURA

Agjencitë e Pavarura përfshijnë 14 Autoritete Kontraktuese me gjithsej 364 njoftime të publikuara sipas tabelës së mëposhtme:

	Numri
Njoftim Kontrate	103 28%
Njoftim per dhenie te kontrates	203 56%
Njoftim anulimi	31 9%
Njoftim paraprak	11 3%
Njoftim i anulimit te kontrates	6 2%
Njoftim per informata shtese ose permiresim i gabimit	10 3%
<b>TOTAL</b>	<b>364</b> <b>100%</b>

Agjencitë e pavarura kanë anuluar 30% apo 31 anulime nga totali i 103 njoftimeve

para dhënies së kontratave sipas arsyeve të mëposhtme:

Anulimet	Numri
Ne mungese te ofertave te pergjegjshme	11
	35%
Opinion te AKK	-
	0%
Tejkalim substancial i buxhetit	1
	3%
Te dhena te pamjftueshme	10
	32%
Te tjera	8
	26%
OSHP	1
	3%
TOTAL	31
	100%

Në 35% të rasteve anulimet u bënë në mungesë të ofertave të përgjegjshme, përderia nuk ka të dhëna mbi arsyet e anulimit të njoftimeve në 32% të rasteve nga totali i njoftimeve të anulimit.

AKK-ja kishte dhënë një varg rekomandimesh në mesin e së cilave tri ishin për Agjencinë Qendrore të Prokurimit (AQP)<sup>139 140 141</sup> njëpër

139 Agjencia kundër korrupsionit "Opinion për Agjencinë qendrore të prokurimit", tetor 2015 [http://www.akk-ks.org/repository/docs/opinion\\_dpkkp-AQP\\_1610201512310800\\_809926.pdf](http://www.akk-ks.org/repository/docs/opinion_dpkkp-AQP_1610201512310800_809926.pdf)

140 Agjencia kundër korrupsionit "Opinion për Agjencinë qendrore të prokurimit", tetor 2015 [http://www.akk-ks.org/repository/docs/opinion\\_dpkkp-AQP\\_332463.pdf](http://www.akk-ks.org/repository/docs/opinion_dpkkp-AQP_332463.pdf)

141 Agjencia kundër korrupsionit "Opinion për Agjencinë qendrore të prokurimit", shtator 2015 [http://www.akk-ks.org/repository/docs/01-2764-15-Opinion-AQP\\_351327.pdf](http://www.akk-ks.org/repository/docs/01-2764-15-Opinion-AQP_351327.pdf)

Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas<sup>142</sup> dhe njëpër Agjencinë e Produkteve Medicinale<sup>143</sup> përmes të cilave rekomandime kërkohej anulimii aktiviteteve të prokurimit. Pavarësisht kësaj institucionet e lartpërmendura nuk i përfillën opinionet e AKK-së.

Numri i njoftimit për dhënie të kontratave në bazë të vlerave klasifikohet sipas tabelës së mëposhtme:

142 Agjencia kundër korrupsionit "Opinion për Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas", tetor 2015 [http://www.akk-ks.org/repository/docs/opinion\\_dpkkp-Agjencia\\_per\\_Ndihme\\_Juridike\\_Falas\\_90949.pdf](http://www.akk-ks.org/repository/docs/opinion_dpkkp-Agjencia_per_Ndihme_Juridike_Falas_90949.pdf)

143 Agjencia kundër korrupsionit "Opinion për Agjencinë e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale", nëntor 2015 [http://www.akk-ks.org/repository/docs/opinion\\_dpkkp-AKPPM\(1\)\\_498541.pdf](http://www.akk-ks.org/repository/docs/opinion_dpkkp-AKPPM(1)_498541.pdf)

	Vlera e kontratave	Numri, Shuma
Të mëdha	Të mëdha	25 12%
	Shuma e kontratave të mëdha	42,002,216 94%
Të mesme	Të mesme	44 22%
	Shuma e kontratave të mesme	1,955,067 4%
Të vogla	Të vogla	134 66%
	Shuma e kontratave të vogla	727,704 2%
	Total kontrata në numër	Total kontrata në vlerë
	203	44,684,987
	100%	100%

Pavarësisht që për nga numri prijnë kontratat e vogla me pjesëmarrje prej 66%, janë kontratat e mëdha me pjesëmarrje prej 94% të cilat renditen në vendin e parë për sa i përket vlerës.

Vlera e tyre në tërësi është 42 milionë euro nga totali i 44.7 milionë eurove të kontraktuara nga Agjencitë e Pavarura.

Vlera prej 2.7 milionë eurove apo 6% i takon kontratave të mesme dhe të vogla.

Vetëm AQP-ja ka 37.4 milionë euro vlera të kontraktuara për prokurime të përbashkëta në nivel qendror, si dhe prokurime me kërkesë të Autoriteteve Kontraktuese.

AQP-ja gjatë vitit 2015 ka zhvilluar 6 aktivitete të prokurimit me kërkesë të AK dhe i ka publikuar në uebfaqen e KRPP-së, 3 aktivitete nuk janë në fazën e implementimit kurse 3 të tjera janë duke u impelmentuar.

Drejtori i AQP-së, Mursel Rracaj, theksoi gjatë intervistës për BIRN-in se 4 kontratat për 3 aktivitete të prokurimit kanë mbetur pezull për arsye se ministri i Financave Adullah Hoti nuk i ka nënshkruar këto të fundit.

“Furnizim me bileta, furnizim me goma, furnizimi me material për zyrë AQP-ja i ka zhvilluar me sukses procedurat e prokurimit por janë lënë pezull për shkak mos nënshkrimit nga ministri”, tha Rracaj.<sup>144</sup>

Rracaj më tej u shpreh se 3 aktivitete të prokurimit që përfshijnë furnizimin me dru dhe pelet, furnizimin me mazut dhe furnizimin me naftë, janë nënshkruar nga ministri dhe janë në implementim.

Kontrata më e madhe e centralizuar e kontraktuar në vitin 2015 nga AQP-ja për 80 Autoritete Kontraktuese në vlerë prej

<sup>144</sup> Intervistë me Drejtorin e AQP-së Mursel Rracaj - Prishtinë 23 shkurt 2015

12.2 milionë euro për 36 muaj, filloi të implementohet.

Kontrata e derivateve u përfol dhe u kritikua shumë nëpër media, për shkak se e fitoi kompania "HIB Petrol" e cila përballet me dy aktakuza për mashtrim.

Policia e Kosovës ka akuzuar kompaninë Hib Petrol për mashtrim për ofertën e rreme për furnizim me derivate me fitim prej zero cent. Aktakuza është ngritur në vitin 2012, rasti është duke u gjykuar, e në seancën e tetorit të viti 2014 Policia e Kosovës si palë e dëmtuar nuk mori fare pjesë në seancë.<sup>145</sup>

Rasti tjetër për të cilën u ngrit aktakuzë në korrik të vitit 2015 për kompaninë Hib Petrol, është akuzë e të cilën e bëri Komuna e Prishtinës për mashtrim me furnizimin me naftë për ngrohje dhe gjeneratorë për 44 institucioneve edukativo arsimore.<sup>146</sup>

Sipas Ligjit për Prokurim Publik 04/L-042 neni 65 pika 3 lejon që të gjithë Operatorët Ekonomikë mund të marrin pjesë në aktivitete të prokurimit dhe kanë të drejtë të fitojë kontrata përdorisa nuk nuk janë të shpallur fajtorë nga ndonjë gjykatë kompetente<sup>147</sup>, si dhe nuk janë në listën e zezë të operatorëve nga OSHP-ja, në rastin konkret ligjërisht kompania "HIB Petrol" ka të drejtë marrjen e tenderëve.

Kompania "Hib Petrol" edhe në vitin 2014 fitoi kontratën 13.8 milionë euro të zhvilluar nga AQP për 37 AK me kërkesë të tyre.

Për kontratën 13.8 milionë euro të AQP-së, Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka realizuar një hulumtim mbi procedurat dhe çmimet e këtij aktiviteti të prokurimit duke konkluduar:

145 Artikulli "Policia mungon në gjykim ku është palë e dëmtuar", tetor 2014 <http://kallxo.com/policia-mungon-ne-gjykimin-ku-eshte-pale-e-demtuar/>

146 Artikulli "Aktakuzë për mashtrim kundër HIB Petrol për naftën në Prishtinë", korrik 2015 <http://kallxo.com/aktakuzen-per-mashtrim-kunder-hib-petroll-per-naften-ne-prishtine/>

147 Ligji për Prokurim Publik <https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/Ligji-per-Prokurim-Publik.pdf>

"Nga analizat e çmimeve të paguara nga institucione të ndryshme, madje edhe me të njëjtin Operator Ekonomikë, mund të konkludojmë se AQP ka siguruar një vlerë mjaft të mirë për parane, në krahasim me Institucionet tjera dhe atë që është qëllimi primar, paguan çmimet më të ulëta se në tregun e pakicës," thuhet në raport.<sup>148</sup>

Mangësi që mund të sjellë kjo kontratë, sipas raportit të KDI-së, është eliminimi i konkurrencës, i cili sjell pozicion jo të mirë për bizneset e vogla duke shpërblyer një operator të vetëm ekonomik.

Kompania "HIB Petrol" është përfituesi më i madh i kontratave publike për furnizim me derivate në vitin 2014 dhe 2015.

Artan Canhasi nga KDI në pyetjen cili ka qenë konstatimi i këtij instituti që tenderin e derivateve e ka fituar kompania Hib Petrol me dy aktakuza të ngritura, tha për Gazetën Jeta në Kosovë se fokusi i raportit nuk ka qenë kompania por Agjencia Qendrore e Prokurimit.

"Fokusi ynë në raport ka qenë vlera për para, dhe në këtë drejtim jemi të kënaqur me punën që e ka bërë AQP-ja për këtë kontratë. Nëse aktakuza ndaj një operatori ekonomik ka të bëjë me mashtrim që shkon në dëm të vlerës për para, atëherë kompania nuk duhet të fitojë kontrata publike deri në vendim të plotfuqishëm të gjykatës, pra, ligji duhet të ndryshohet, që të marrë parasysh këto situata dhe të mos shpërblejë me kontrata operatorët të cilët janë të akuzuar për mashtrime", tha Canhasi.<sup>149</sup>

Kosova që nga viti 2012 nuk ka mbrojtje të konkurrencës për arsye të mos funksionimit të Autoritetit Rregullativ të Konkurrencës.

Qeveria e Kosovës ka katër vjet që lejon që Autoriteti Kosovar i Konkurrencës të jetë

148 Instituti Demokratik i Kosovës "Paraja publike apo konkurrenca?", dhjetor 2015 <http://www.kdi-kosova.org/publikime/25-paraja-publike-apo-konkurrenca.pdf>

149 Përgjigje me imejll Artan Canhasi KDI, qershorë 2016.

jofunksional, pasi ky mekanizëm shtetëror tashmë nuk ka asnjë anëtar të bordit. Qeveria ende nuk ka lëvizur drejt kompletimit të funksionalizimit të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës që ka për detyrë luftimin e monopolit.<sup>150</sup>

Qeveria cakton bordin, kryetarin dhe anëtarët tjerë të Autoritetit, i cili mbikëqyret nga Komisioni Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri.

Komisioni në fjalë nuk ka pasur se çka të mbikëqyrë sa i takon këtij institucioni, i cili ekziston më së shumti vetëm si emër.

Misioni i këtij Autoriteti ka për qëllim të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë së tregut të Kosovës duke ndaluar veprimet që kufizojnë, shtypin ose çrregullojnë

konkurrencën. Ky ligj vepron për të siguruar një konkurrencë të lirë dhe efektive në treg duke u mbështetur në tre shtylla kryesore që përcaktojnë mbrojtjen e konkurrencës:

- Abuzimin me pozitën dominuese;
- Marrëveshjet e ndaluara në formën e karteleve dhe
- Bashkimet ose përqendrimit e ndërmarrjeve,<sup>151</sup>

Në Prokurimin Publik në Kosovë shihet qartë se disa biznese kanë pozitë dominuese në marrjen e tenderëve, ka marrëveshje në formën e karteleve të cilat i bëjnë vetë kompanitë për ta ndarë tregun, si dhe bashkimet e kompanive me konzorciume, përderisa punën e kryen kompania e vetme.

## PROJEKTET E MËDHA KAPITALE

Për termocentralin shumë të përfolur “Kosova e Re” Qeveria që nga fillimi ka qenë jo transparente në përzgjedhjen e kompanisë për ndërtimin e saj. Ministria e Zhvillimit ekonomik për disa muaj me radhë ka zhvilluar negociata me “Contour Global” me të vetmën kompani të mbetur nga ofertat tjera për ndërtimin e termocentralit “Kosova e Re”:

Ministri Blerand Stavileci para Komisionit për Zhvillim Ekonomik në dhjetor të vitit 2015 ka paraqitur vetëm të dhënat e përgjithshme mbi ecurinë e këtij projekti, “Kosova e Re” është parashikuar të ndërtohet 30% nga kompania “Contour Global” dhe 70% me kredi nga Banka Botërore, por kredituese do të jetë e njëjta kompani “Contour Global”.<sup>152</sup>

Termocentrali parashikohet të jetë funksional pas 7 viteve në vitin 2022, kurse aktivitetet e prokurimit do t'i udhëheqë vet kompania “Contour Global” për të kontraktuar kompani të Kosovës për ndërtim të këtij termocentrali.

Gazeta Jeta në Kosovë ka bërë disa hulumtime për termocentralin e shumëpërfolur dhe në shkurt të vitit 2015 ka publikuar një përmbledhje të rezultateve, nga Ranjit Lamech, menaxher i sektorit të energjisë për Evropë nga Banka Botërore, ku jepen shpjegime si të vazhdohet me tenderin kontravorz.<sup>153</sup>

Sipas Lamech nuk është tragjedi që Kosova të nënshkruajë kontratë me kompaninë e vetme

150 Artikulli “Qeveria lejon ‘paralizimin’ e anti monopolit”, dhjetor 2015 <http://kallxo.com/gjnk/qeveria-lejon-paralizimin-e-anti-monopolit/>

151 Autoriteti Kosovar i Konkurrencës <https://ak.rks-gov.net/?cid=1,21>

152 Artikulli “Rryma e shtrenjtë e ‘Kosovës së Re’ në vitin 2022”, dhjetor 2015 <http://kallxo.com/rryma-e-shtrenjte-e-kosoves-se-re-ne-vitin-2022/>

153 Artikulli “Zarfi” i Bankës Botërore për Termocentralin “Kosova e Re”, shkurt 2015 <http://kallxo.com/gjnk/zarfi-i-bankes-boterore-per-termocentralin-kosova-e-re-1/>

Contour Global sepse një gjë e tillë ka pasur sukses në Armeni.

Në uebfaqen e MZHE-së është publikuar një komunikatë më 26 maj 2016 në ditën kur po zhvillohej Panairi Ndërkombëtar i Ndërtimit, Energjetikës dhe Teknikës “EXPOKOS” në Prishtinë, ku Ministri Blerand Stavileci theksoi se projekti i cilit pritet të nis në pranverë të vitit të ardhshëm do t’i sjellë shumë benefite Kosovës në disa dimensione. “Përveç dimensionit sektorial në sigurimin e furnizimit të qëndrueshëm dhe cilësor me energji elektrike, kemi edhe dimensionin social, meqenëse bëhet fjalë për mijëra vende pune, të cilat do të krijohen dhe dimensionin mjedisor, sepse do të përdoret teknologji e avancuar e cila mbron mjedisin”, kishte theksuar ai.<sup>154</sup>

Asnjë sqarim nga Ministria rreth anës ligjore, termocentralit më shumë është duke iu bërë marketing në aspektin social për hapjen e vendeve të reja të punës, se sa dëmtimi i konsumatorëve për ofertën e shtrenjtë të cilën do ta bartin vet ata me tarifat e larta të energjisë elektrike që do të dalin nga ky termocentral

Brezovica ishte dhënë me koncesion në shfrytëzim për 99 vite<sup>155</sup>. Kjo kontratë ishte nënshkruar në prill të vitit 2015, ndërmjet qeverisë me konzorcium “Compagnie des Alpes SA & MDP Consulting & PGIManagmanet & Outdoor Kosovo”.

Edhe për këtë projekt kishte folur Ranjit Lamech nga Banka Botërore duke e cilësuar marrëveshjen e nënshkruar me kompaninë e vetme për qendrën e skijimit si të suksesshëm dhe projekti i Brezovicës mund t’i hapte rrugë TC Kosova e Re.

Ai kishte sugjeruar që qeveria e Kosovës të mund të vazhdojë edhe me vetëm një ofertues pasi që “ka pasur një përvojë të tillë së fundmi,

154 Lajme nga uebfaqja e MZHE “TC Kosova e Re me benefite socio-ekonomike e mjedisore”, maj 2016 [http://mzhe-ks.net/sq/lajmet/tc-kosova-e-re-me-benefite-socio-ekonomike-e-mjedisore#.V0xl\\_NR97Dc](http://mzhe-ks.net/sq/lajmet/tc-kosova-e-re-me-benefite-socio-ekonomike-e-mjedisore#.V0xl_NR97Dc)

155 Artikulli “Brezovica ‘rreshqet’ te francezët”, nëntor 2014 <http://kallxo.com/gjnk/brezovica-rreshqet-te-francezet-1/>

kur një ofertues i vetëm u pranua në një shitje konkurruese/proces të koncesionimit për zhvillimin e një resori të skijimit”.<sup>156</sup>

Projekti i Brezovicës si ai i TC Kosova e Re nga Ministritë përgjegjëse që udhëheqën procedurat negociuese nuk shpjeguan shumë para qytetarëve mbi ecuritë e atyre bisedimeve.<sup>157</sup>

Për Brezovicën ishin shkelur të gjitha afatet ligjore për përmbushjen e kontratës, ndërsa në qershor 2016 ky projekt dështoi, për shkak se kompania franceze nuk kishte arritur të përmbushte ofertën financiare dhe të siguronte mjetet e nevojshme për implementimin e zhvillimit të projektit<sup>158</sup>

Lavdatat dhe kushtet e Bankës Botërore, së bashku me aprovimin e Qeverisë se projektet e mëdha kapitale mund të finalizohen me nga një kompani të vetme në garë me negociim të drejtpërdrejtë, e tregon “suksesi” i projektit të Brezovicës, e pritjet për projektin e TC Kosova e RE sa do të jetë i suksesshëm.

156 Artikulli “Zarfi” i Bankës Botërore për Termocentralin “Kosova e Re”, shkurt 2015 <http://kallxo.com/gjnk/zarfi-i-bankes-boterore-per-termocentralin-kosova-e-re-1/>

157 Artikulli “Brezovica – shkelet afati për nënshkrimin e kontratës”, prill 2015 <http://kallxo.com/gjnk/brezovica-shkelet-afati-per-nenshkrimin-e-kontrates/>

158 Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, komunikatë për media, qershorë 2016 <http://www.mti-ks.org/sq/Aktivitetet-e-Ministres/Komunikate-per-Media-Projekti-per-Zhvillimin-e-Qendres-Turistike-te-Brezovices-3494-3494>

# ZYRA E KRYEMINISTRIT

Zyra e Kryeministrit ka publikuar gjithsej 33 njoftime sipas tabelës së mëposhtme:

	Numri
Njoftim Kontrate	9 27%
Njoftim per dhenie te kontrates	22 67%
Njoftim anulimi	1 6%
<b>TOTAL</b>	<b>32</b> <b>100%</b>

Krahasuar me vitin 2014 kur ishin të publikuara 80 njoftime, viti 2015 e gjen Zyrën e Kryeministrit me 32 njoftime të publikuara për të gjitha kategoritë. Pranimi i publikimeve është për 59% më i ulët se në vitin 2014.

Vetëm një njoftim është anuluar para dhënies së kontratës në mungesë të ofertës së përgjegjshme.

Kontratrat në bazë të vlerave janë klasifikuar sipas tabelës së mëposhtme:

	Vlera e kontratave	Numri, Shuma
Të mëdha	Të mëdha	1 5%
	Shuma e kontratave të mëdha	235,000 48%
Të mesme	Të mesme	5 23%
	Shuma e kontratave të mesme	175,327 36%
Të vogla	Të vogla	16 73%
	Shuma e kontratave të vogla	78,108 16%
	Total kontrata në numër	Total kontrata në vlerë
	22 100%	78,108 16%



Poashtu, edhe vlerat e njoftimeve për dhënien e kontratave në vitin 2015 janë për 29% më të ulëta. Nga 683 mijë euro sa ishin publikuar në vitin 2014, këtë vit vlere totale kontratave arrin në 488 mijë euro.

Zyra e Kryeministrit në vitin 2014 pati shkelur ligjin e prokurimit me ndarjen e tenderëve në kontrata të vogla për furnizim me mallra të IT duke e anashkaluar konkurrencën.<sup>159</sup>

Këto kontrata janë gjetur nga BIRN përmes publikimit në faqen e KRPP-së. Gjetjet i konfirmoi edhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm:

“Në Zyrën e Kryeministrit ishin zhvilluar gjashtë procedura të prokurimit, të ndara në periudha të ndryshme, për furnizim me mallrat e teknologjisë informative me vlerë totale 74,913 €, kjo kishte rezultuar ngase njësitë kërkuese kishin bërë kërkesa për furnizim të cilat nuk ishin planifikuar në fillim të vitit,” thuhet në raportin e auditimit.<sup>160</sup>

\*\*\*

Gazeta Jeta në Kosovë gjatë vitit 2015 zbuloi se Zyra e Kryeministrit kishte shpërblyer me tender djemtë e kryeministrit Isa Mustafa. Tenderin për servisimin e automjetit të Zyrës së Kryeministrit Isa Mustafa e fitoi servisi “Makcar” pronarë të së cilës janë vetë djemtë e kryeministrit, Besnik dhe Arben Mustafa.<sup>161</sup>

Ky skandal u komentua dhe u përfol edhe nga disa media ndërkombëtare, ndër to agjencia e lajmeve Reuters, EuroNews e Daily Mail. Kjo e fundit raportoi për këtë hulumtim duke thënë se kryeministri i Kosovës, Isa Mustafa, ka përdorur Facebook-un për ta mbrojtur pagesën për një kompani të

drejtuar nga djali i tij për ta servisuar një nga veturat e tij zyrtare, duke nxitur “ankesa për nepotizëm në një vend përplot korrupsion”.<sup>162</sup>

Pesë ditë pas publikimit të hulumtimit në gazetën Jeta në Kosovë, Besnik Mustafa, i biri i kryeministrit, postoi në Facebook njoftimin se është tërhequr nga kontrata me Zyrën e Kryeministrit.

Besnik Mustafa përmes këtij deklarimi kishte deklaruar se tërhiqej nga kontrata e tenderit për servisimin e automjetit për Zyrën e Kryeministrit për shkak fushatës mediatike, duke theksuar se kompania e tij do t'i bart vetë shpenzimet e porositjes së pjesëve për servisim.<sup>163</sup>

Por edhe Kryeministri Isa Mustafa kishte deklaruar se nuk ishte në dijeni se kompania “Makcar” e djemve të tij kishte fituar tender në zyrën e tij duke deklaruar:

“Po meqenëse e di. Tash unë ia ndaloj atij (Besnik Mustafës, menaxher i Makcar) me marrë (servisu) kerr të Qeverisë”, tha Mustafa.

159 Raporti i Monitorimit të Prokurimit Publik në Kosovë 2014 “Arka e Favoreve”, shkurt 2015 [http://jetanekosove.com/repository/docs/BIRN-shqip\\_350845.pdf](http://jetanekosove.com/repository/docs/BIRN-shqip_350845.pdf)

160 Zyra e Auditorit të Përgjithshëm “Raporti i auditimit për pasqyrat financiare të Zyrës së Kryeministrit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014”, qershor 2015 [http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit\\_ZKM\\_2014\\_Shqip\\_796412.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_ZKM_2014_Shqip_796412.pdf)

161 Artikulli “Djemtë e Isa Mustafës fitojnë tenderë nga Kryeministria”, gusht 2015 <http://kallxo.com/gjnk/djeme-e-isa-mustafes-fitojne-tendere-nga-kryeministria/>

162 Artikulli “Hulumtimi i Gazetës Jeta në Kosovë për tenderin e Kryeministrit, jehonë në mediat e huaja”, gusht 2015 <http://kallxo.com/gjnk/hulumtimi-i-gazetes-jeta-ne-kosove-per-tenderin-e-kryeministrise-jehone-ne-mediat-e-huaja/>

163 Artikulli “Cila deklaratë e protagonistëve të ‘BMË skandalit’ është mashtrim?”, gusht 2015 <http://kallxo.com/gjnk/cila-deklarate-e-protagonisteve-te-bme-skandalit-eshte-mashtrim/>

# KUVENDI I KOSOVËS

Kuvendi ka publikuar gjithsej 33 njoftime sipas tabelës së mëposhtme:

	Numri
Njoftim Kontrate	44 42%
Njoftim per dhenie te kontrates	27 26%
Njoftim anulimi	33 32%
TOTAL	104 100%

Nga 44 njoftime të publikuara para dhënies së kontratës janë anuluar 75% apo 33 njoftime sipas arsyeve të poshtëshënuara.

Anulimet	Numri
Ne mungese te ofertave te pergjegjshme	28 85%
Opinion te AKK	0 0%
Tejkalim substancial i buxhetit	4 12%
Te dhena te pamjaftueshme	0 0%
Te tjera	1 3%
TOTAL	33 100%

Në 85% të rasteve këto anulime janë bërë në mungesë të ofertave të përgjegjshme.

Vlerat e njoftimit për dhënien e 27 kontratave arrin në 426 mijë euro të klasifikuara sipas tabelës së mëposhtme.

	Vlera e kontratave	Numri, Shuma
Të mëdha	Të mëdha	0 0%
	Shuma e kontratave të mëdha	0 0%
Të mesme	Të mesme	11 41%
	Shuma e kontratave të mesme	373,314 88%
Të vogla	Të vogla	16 59%
	Shuma e kontratave të vogla	52,822 12%
	Total kontrata në numër	Total kontrata në vlerë
	27	426,136
	100%	100%

Kuvendi në vitin 2015 ka planifikuar të shpenzojë 72% më pak se në vitin e kaluar, nga 1.5 milion sa ishte vlera në vitin 2014, në vitin 2015 arriti në 426 mijë euro.

\*\*\*

Kuvendi i Kosovës ka tenderuar bombola për fikjen e zjarrit në vlerë prej 3 mijë eurove në qershorë të vitit 2015 nga kompania "Pastor Kosova", por dy bllokimet që ndodhën në kuvend gjatë vitit 2015 nga hedhja e gazit lotsjellësit nuk aktivizuan asnjë pajisje për fikjen e zjarrit.

Por faji nuk kishte qenë te paisjet se ato nuk kanë punuar, por te kuvendi i cili nuk i kishte aktivizuar ato, me arsyen se nuk ka pasur nevojë sepse ka qenë aktive kujdestaria.<sup>164</sup>

164 Artikulli "Kuvendi nuk kishte aktivizuar pajisjet anti-zjarr në seancën me gaz lotsjellës", tetor 2015 <http://kallxo.com/kuvendi-nuk-kishte-aktivizuar-pajisjet-anti-zjarr-ne-seancen-me-gaz-lotsjelles/>

Pamvarësisht që kuvendi shpenzon qdo vit për mirëmbajtjen e mjete për fikjen e zjarrit në vlerë prej 3 mijë eurove, ato mbeten të fikura dhe ndezen vetëm kur ka dëshirë stafi i kuvendit.

Kuvendi i Kosovës në vitin 2014 kishte kontraktuar tenderin në vlerë prej 11 mijë e 860 euro për blerjen e iPad-ve<sup>165</sup>, por sipas Institutit GAP<sup>166</sup>, përkundër asaj se çdo vit Kuvendi blen laptopë dhe iPad-e, kjo nuk ka rezultuar me zvogëlimin e shpenzimeve të letrës, kopjimit dhe printimit.

165 Raporti i Monitorimit të Prokurimit Publik në Kosovë 2014 "Arka e Favoreve", shkurt 2015 [http://jetanekosove.com/repository/docs/BIRN-shqip\\_350845.pdf](http://jetanekosove.com/repository/docs/BIRN-shqip_350845.pdf)

166 Instituti GAP "Sa ka ndikuar blerja e laptopëve për deputetët e Kuvendit në shpenzimet e Kuvendit për letër dhe printim?", prill 2015 <http://www.institutigap.org/lajme/729>

# ZYRA E PRESIDENTIT

Zyra e Presidentit ka publikuar gjithsej 33 njoftime sipas tabelës së mëposhtme:

	Numri
Njoftim Kontrate	7
	16%
Njoftim per dhenie te kontrates	34
	79%
Njoftim anulimi	2
	5%
TOTAL	43
	100%

Ka pasur vetëm 2 anulime para dhënies së kontratës në mungesë të ofertave të përgjegjshme.

Zyra e Presidentit në vitin 2015 e rriti vlerën e kontratave për 62% krahasuar me vitin paraprak, nga 226 mijë euro të kontraktuara në vitin 2014, shuma e kontratave arriti në 582 mijë euro në vitin 2015.

	Vlera e kontratave	Numri, Shuma
Të mëdha	Të mëdha	0 0%
	Shuma e kontratave të mëdha	0 0%
Të mesme	Të mesme	5 15%
	Shuma e kontratave të mesme	391,116 67%
Të vogla	Të vogla	29 85%
	Shuma e kontratave të vogla	190,852 33%
	Total kontrata në numër	Total kontrata në vlerë
	34	582,068
	100%	100%

Përderisa në vitin 2014 Zyra e Presidentit ka pasur më shumë kontrata të vogla në përjashtim të 3 kontratave me vlerë të mesme prej 69 mijë euro, në vitin 2015 vlera e kontratave të mesme u rrit për 82% dhe arriti vlerën 391 mijë euro.

Kontrata për shërbim, servisim mirëmbajtjes për tre tipe të automjete u kontraktuan si:

Për tipin Toyota u kontraktuan  
**181 mijë euro**

Për tipin Audi u kontraktuan  
**43 mijë euro**

Për tipin Chevrolet u kontraktuan  
**8,225 euro**

Sigurimi i automjeteve u kontraktuan  
**11,492 euro**

Gomat për automjete u kontraktuan  
**9,580 euro,**

Derivate për këto automjete u kontraktuan  
**55,550 euro**

Për t'u pastruar këto automjete u kontraktuan  
**8,400 euro,**

BIRN ka kontaktuar Zyrën e Presidentit për ta pyetur sa vetura ka në shfrytëzim.

Përmes emailit kjo zyrë është përgjigjur që posedon gjithsej 25 vetura të blera gjatë periudhës 2002-2005.

“Zyra e Presidentit i ka 25 vetura, 12 vetura të tipit Toyota, 7 Chevrolet, 3 Audi, 1 VË Polo, 1 VË Kombi, 1 Mercedes, veturat janë blerë gjatë periudhës 2002-2005,” thuhet në email.

Për automjete 10 deri në 13 vite të vjetra Zyra e Presidentit në total planifikon të shpenzojë 317 mijë euro.

Ndërsa udhëtimet e transportit ajror u kontraktuan me 100 mijë euro.

## MUNGESA E VLERAVE TË PËRAFËRTA TË KONTRATAVE

Në 2015, KRPP-ja nxori Udhëzimin Administrativ 02/2015 për kontratat publike kornizë ku qartë specifikon si duhet të përdoret një kontratë e tillë:

“Kontrata kornizë maksimum mund të ketë kohëzgjatje prej 36 muaj, sasia e specifikuar në dosjen e tenderit nuk mund të përcaktohet saktë sepse është sasi indikative, por AK duhet që për sasi dhe vlerë të këtyre kontratave të përcaktojë një prag dhe një tavan dhe nuk duhet të lejojë devijimin e tij, duke deklaruar poashtu për qindjen e mospërputhjes së lejuar e cila nuk mund të jetë më e lartë se plus/minus 30%.”<sup>167</sup>

<sup>167</sup> KRPP, “Udhëzim Administrativ Nr. 2/2015 Për Kontratat publike kornizë”, mars 2015 <https://krpp.rks-gov.net/krpp/PageFiles/File/Udhezimet%20Adminis%202015/UA%202%202015%20per%20Kontratat%20Publike%20Kornize.pdf>

Disa autoritete kontraktuese nuk e përfillën këtë udhëzim administrativ dhe vazhduan sikurse në vitin 2014, duke publikuar kontrata kornizë pa specifikuar sasi dhe vlerë të përafërt.

Në vitin 2015, gjatë monitorimit të publikimit të kontratave, janë vërejtur se 48 AK në 61 publikime për dhënie të kontratës nuk kanë specifikuar vlerat e përafërta të kontratës:

Autoriteti Kontraktues	Shërbime të transportit	Sigurimi i objekteve	Furnizim me pajisje të IT	Furnizim me derivate mazut	Furnizim me material medicinal	Servisimi i automjeteve	Tjera	Vlera
MFSK				1				
M. Infrastrukturës						1		
MMPH	1						4	42,678
MPJ							1	
MSH				1				
QKMF Mitrovicë					1			
MTI							3	1,284
Dogana e Kosovës			1				1	68,038
Gjykata Kushtetuese							1	10,500
Inspetoriati Policor							1	3,712
Institi Gjygsorë						1		880
Instituti i Mjeksisë së Punës Gjakovë						1		3,048
Shërbimi i Shëndetit Mendorë Shtime				1				29,551
Shërbimi i Shëndetit Mendorë Mitrovicë							1	1,440
Spitali i Vushtrrisë				1				
Spitali i Gjakovës				1				20,000
Spitali i Mitrovicës					1			
Spitali i Pejës							1	1,470
Spitali i Prizrenit				1				
AKK		1					1	37,000

Autoriteti Kontraktues	Shërbime të transportit	Sigurimi i objekteve	Furnizim me pajisje të IT	Furnizim me derivate mazut	Furnizim me material zyre	Shërbime të ushqimit	Shërbime të internetit dhe telefonis	Tjera	Vlera
Komuna e Dragashit	2								
Komuna e Drenasit		1							
Komuna e Gjakovës	1								42,224
Komuna e Gjilanit			1	1					
Komuna e Hanit të Elezit			1						50,000
Komuna e Kamenicës			1						7,975
Komuna e Klinës			1						30,000
Komuna e Lipjanit					1	1			76,317
Komuna e Novo Brdos			1						6,000
Komuna e Parteshit			1						
Komuna e Podujevës	2							1	76,718
Komuna e Ranillugut				1			1		
Komuna e Vitisë							1		2,100

BIRN përmes emailit ka kontaktuar të gjitha AK-të për të marrë vlerat e përafërta të kontratave.

Nga 48 AK të kontaktuara janë përgjigjur vetëm 23 prej tyre sipas tabelës së lartëshënuar, ku vlera totale këtyre kontratave arriti në 981,030 euro.

Nga tabela vërehet se AK-të në shumicën e rasteve e kanë të vështirë t'i kalkulojnë shërbimet, ndërsa sa i përket furnizimeve e kanë të vështirë t'i kalkulojnë derivatet dhe pajisjet e IT.

Për mospublikimin e vlerave të përafërta të kontratave në formularët standardë, BIRN ka intervistuar drejtorët e zyrave të prokurimit për arsyeën pse po i publikojnë kontratat pa vlera.

Artan Jaha nga Divizioni i Prokurimit në Ministrinë e Bujqësisë gjatë intervistës thase formularët janë ripublikuar pa vlera pasi KRPP-ja nuk i ka kthyer mbrapa për përmirësim:

“Në rast të mos vendosjes së vlerës së përgjithshme apo të përafërt të kontratës KRPP-ja na i kthen njoftimet, nuk na janë kthyer dhe kështu ne i kemi ripubliku,” tha Jaha.<sup>168</sup>

Fatos Shala nga divizioni i prokurimit të MAPL-së theksoi se ministria ku ai punon nuk i dërgon në KRPP kontratat pa vlera sepse pastaj ato kthehen mbrapa.

“Ne vazhdimisht e vendosim vlerën e përgjithshme të kontratës se pa këtë vlerë nuk na i publikon KRPP-ja”, tha Shala.<sup>169</sup>

KRPP-ja ende ballafaqohet me mungesë stafi, dhe monitorimi i publikimit të njoftimeve deri në fund të vitit 2015 është bërë vetëm për kontratat e mëdha. Me ligjin e ri do të monitorohen edhe kontratat e mesme, përderisa kontratat e vogla nuk janë në plan të monitorohen.

Kryetari i KRPP-së, Safet Hoxha, në një intervistë për BIRN theksoi se stafi i mjaftueshëm dhe adekuat është parakusht për të ndërtuar sistem më të mirë të prokurimit.

“Ne e kemi pasur monitorimin e publikimit të kontratave të mëdha në mënyrë që t'i eliminojmë parregullsitë në dosjet e tenderit, ndërsa në vitin 2016 kemi filluar edhe monitorimin e kontratave me vlerë të mesme, kjo kërkon resurse shtesë, çështje që ne e kemi adresuar ngase është parakusht për ndërtimin e një sistemi më të mirë të prokurimit, tha Hoxha.<sup>170</sup>

Për problemin e publikimit të kontratave pa vlera të përafërta Hoxha theksoi se vazhdimisht ka pasur përpjekje për rregullimin e kësaj çështjeje, duke filluar qëvitin e kaluar me një udhëzim administrativ. Ndërsa me ligjin e ri, sipas Hoxhës, udhëzimi administrativ për kontratat kornizë është përfshirë në ligj, tash e tutje publikimi pa vlera të përafërta do të rregullohet me ligj.

Në raste të tilla KRPP-ja pavarësisht se në vitin 2015 e ka pasur vetëm monitorimin e publikimit të kontratave të mëdha, njëkohësisht është dashur të monitorojë edhe publikimin e të gjitha kontratave kornizë për të parë se a po zbatohet udhëzimi administrativ 02/2015 të cilin e ka nxjerrur vetë.

Sipas monitorimeve tona rezulton se KRPP nuk ka bërë monitorim efektiv në publikimin e kontratave kornizë, nuk i ka kthyer mbrapa formularët tek institucionet për të vendosur vlerën e përafërt të kontratës, e këtë nuk e arsyeton mungesa e stafit por pakujdesia për zbatimin e udhëzimeve administrative.

168 Intervistë me Artan Jahajn - Prishtinë 28 Janar 2016

169 Intervistë me Fatos Shalën - Prishtinë 08 shkurt 2016

170 Intervistë me Safet Hoxhën - Prishtinë 08 shkurt 2016



## ÇMIMI MË I LARTË VS ÇMIMI MË I ULËT

Gjatë monitorimit të kontratave ëshë vërejtur një fakt interesant te publikimi i vlerave të përgjithshme të kontratave.

Te formulari standard përveç që duhet të figurojë tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët, i cili shpallet fitues, duhet të figurojë edhe tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të lartë.

Komuna e Ferizajt është ajo e cila në dy tenderë të ndryshëm pati dallime në vlera, kontraktoi ato më të lirë.

Për kontratën e studimit të fizibilitetit për Zonën Ekonomike në fshatin Babush, komuna e Ferizajt kishte planifikuar të shpenzonte më shumë se 10 mijë euro duke e klasifikuar këtë kontratë si të mesme, por fizibilitetin e përfundoi me 7 mijë e 800 euro duke mposhtur ofertën e 22 mijë eurove.

Tenderin efitoi Edmond Hajrizi nga Kolegji i Biznesit dhe Teknologjisë UBT, duke e mposhtur kompaninë private "Intertech".

Ky fakt tregon seriozitetin për matje fizibile për një projekt me rëndësi ekonomike, kur një kolegji bën analiza 65% më lira se një kompani private.

Një kontratë tjetër e klasifikuar si e mesme nga komuna e Ferizajt e që kishte të bënte me furnizim me elektromaterial u kontraktua në shumën prej 7 mijë e 800 eurosh, derisa oferta më e lartë ishte 31 mijë e 600 euro apo 4 herë ose 75% më e lartë se ajo e kontraktuar.<sup>171</sup>

Komuna e Novo Bërdës ka kontraktuar hartimin e projekteve të kësaj komune, e klasifikuar si kontratë e mesme me 1 mijë e 080 euro, ndërsa oferta më e lartë është 15

mijë e 667 euro, 85 herë më e lartë apo 93% më e shtrenjtë se ajo e kontraktuar.<sup>172</sup>

Kompania Rajonale e Ujësllësit Bifurkacioni Ferizaj ka kontraktuar shërbimin për "Vlerësimin teknik dhe financiar të sistemeve urbane dhe ruraletë ujësllësit" në shumën prej 10 mijë e 650 euro. Oferta më e lartë për këtë tender ka qenë 68 mijë e 888 euro, 6 herë më e lartë apo 75% më e shtrenjtë se vlera e kontraktuar.<sup>173</sup>

Kompania Rajonale e Mbeturinave "Pastrimi" Prishtinë i ka kontraktuar tonerat në vlerë prej 791 eurosh, derisa ofertën më të shtrenjtë e ka pasur 6 mijë e 765 euro, 8 herë më të lartë apo 88% më e shtrenjtë se ajo e kontraktuar.<sup>174</sup>

QKUK-ja ka kontraktuar 20.400 copë citostatikë me çmim 6.80 euro me vlerë totale prej 137,720 euro, duke e mposhtur ofertën më të shtrenjtë ku një citostatik kushton 83 euro dhe vlera për 20.400 copë arrin 1.7 milion euro, 12 herë më e lartë apo 92% më e shtrenjtë se vlera e kontraktuar.<sup>175</sup>

Edhe Kuvendi i Kosovës i ka blerë tonerat shumë të lirë me 2 mijë e 106 euro, duke e mposhtur ofertën e 27 mijë eurove, 13 herë më e lartë apo 92% më e shtrenjtë se ajo e kontraktuar.<sup>176</sup>

172 KRPP "Njoftim për dhënie kontrate", mars 2015 <https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=1&CtlID=VieëNotices&ID=96996>

173 KRPP "Njoftim për dhënie kontrate", gusht 2015 <https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=1&CtlID=VieëNotices&ID=104618>

174 KRPP "Njoftim për dhënie kontrate", prill 2015 <https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=1&CtlID=VieëNotices&ID=97914>

175 KRPP "Njoftim për dhënie kontrate", dhjetor 2015 <https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=1&CtlID=VieëNotices&ID=110218>

176 KRPP "Njoftim për dhënie kontrate", mars 2015 <https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=1&CtlID=VieëNotices&ID=96337>

171 KRPP "Njoftim për dhënie kontrate", dhjetor 2015 <https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=1&CtlID=VieëNotices&ID=111851>

MPB-ja servisimin e fotokopjeve do ta kryejë me 17 mijë e 136 euro, derisa oferta më e lartë ishte 81 mijë e 463 euro, 5 herë më e lartë apo 79% më e shtrenjtë se ajo e kontraktuar.<sup>177</sup>

KEK-u po ashtu ka kontraktuar susta goditëse me 9 mijë e 651 euro, derisa oferta më e shtrenjtë ka qenë 82 mijë e 060 euro, apo 8

herë më e lartë apo 88% më e lartë se vlera e kontraktuar.<sup>178</sup>

Te 9 kontrata të ndryshme vërehet një dallim i madh mes çmimit të kontraktuar dhe atij të ofruar.

## KORRUPSIONI NË PROKURIM PUBLIK

Viti 2015 u përshkua me gjykime, aktakuza madje edhe dënime të zyrtarëve të prokurimit.

Korrupsioni në prokurim publik nuk po luftohet sa duhet nga asnjëri mekanizëm shtetrorë duke u nisur nga OSHP si gjykatë e tenderëve e deri te gjykatat kompetente kur lëndët zvarriten dhe vjetërsohen e në fund hudhen si të pabaza.

Poashtu edhe denimet e kësaj natyre janë shumë të ulta, duke bërë që të akuzuarit për vepra penale korruptive të mos ndjenjë qëllimin e paraparë me Kodin Penal të Republikës së Kosovës.

Këtë e dëshmon edhe raporti i monitorimit të gjykatave për vitin 2015 nga BIRN dhe **Internews** Kosova i publikuar në maj 2015<sup>179</sup>

Të gjeturat në raport tregojnë se sipas të dhënave të Sekretariatit të Këshillit Gjygjësor të Kosovës për rastet nga kapitulli i veprave penale të korrupsionit, në 2015 janë zgjedhur gjithsej 121 lëndë, prej të cilave 19 lëndë kanë përfunduar me aktgjykime liruese.

Kjo dëshmon se rastet korruptive janë vështirë për t'u vërtetuar, apo që prokuroria nuk sjell prova të mjaftueshme, duke bërë që kryesit e veprave të mbesin pa e marrë dënimin e merituar, e ato pak raste të denuara shpeshherë janë denime me kusht edhe për kundër faktit se Kodi Penal parasheh dënime të larat për kryesit e veprave penale të korrupsionit.

Nga Prokuroria Speciale nuk kemi marrë përgjigje për aktakuzat e ngritura në vitin 2015 për keqpërdorime me tenderë, përderisa prokuroria themelore e Ferizajt gjatë vitit 2015 ka ngritur 5 aktakuza me 19 persona të përfshirë në keqpërdorime me tenderë, ajo e Prizrenit ka ngritur 2 aktakuza, përderisa Prokuroria e Pejës dhe ajo e Gjakovës nuk kanë ngritur asnjë aktakuzë për keqpërdorime me tenderë.

177 KRPP "Njoftim për dhënie kontrate", shtator 2015 <https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=1&CtlID=VieëNotices&ID=105468>

178 KRPP "Njoftim për dhënie kontrate", mars 2015 <https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=1&CtlID=VieëNotices&ID=96304>

179 Raporti i monitorimit të gjykatave 2015, maj 2016 [http://kallxo.com/ep-content/uploads/2016/05/BIRN-court-report-2015\\_ALB\\_ëeb.pdf](http://kallxo.com/ep-content/uploads/2016/05/BIRN-court-report-2015_ALB_ëeb.pdf)

153 Artikulli "Zarfi" i Bankës Botërore për Termocentralin "Kosova e Re", shkurt 2015 <http://kallxo.com/gjnk/zarfi-i-bankes-boterore-per-termocentralin-kosova-e-re-1/>

## Aktakuzat ndaj Hysni Hoxhës dhe skandalet e OSHP-së

Aktakuza e ngritur nga Prokuroria Speciale e Kosovës ndaj Kryetarit të OSHP-së Hysni Hoxhës, ekspertit të mbrendshëm të OSHP-së Hysni Muhadrit, pronarit të kompanisë “Canex Group” Veton Fetahut si dhe kontabilistit të kësaj kompanie Arsim Robellit, është duke u gjykuar nga Gjykata Themelore e Prishtinës.

Veton Fetahu pronarë i kompanisë “Canex Group” në vitin 2013 kishte mashtruar OSHP-në me dokumentacione të falsifikuara të Administratës Tatimore të Kosovës ATK për ndërtimin e lokaleve afariste në qytezën Pejton.

Për këtë rast Hysni Hoxha si Kryetar i OSHP-së, dhe Hysni Muhadri në cilësinë e ekspertit shqyrtues të OSHP-së, akuzohen se në bashkëveprim dhe duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar me dashje, direkt i kishin sjellur dobi materiale në shumë prej 1,8 milion euro kompanisë “Conex Group”.

Në seancën fillestare të mbajtur në gusht 2015 Hysni Hoxha, Hysni Muhadri dhe Arsim Robelli nuk e kishin pranuar fajësinë, përderisa Veton Fetahu, më 10 mars 2015 kishte arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë me prokurorin, dhe në këtë marrëveshje ishin dakorduar që për veprat për të cilat akuzohet, të dënohet me 6 muaj burg efektiv dhe 16.000 euro.<sup>180</sup>

Pas ngritjes së aktakuzës për rastin e “Canex Group” në dhjetor 2014 Hysni Hoxha në një konferencë për media, pati deklaruar se ai nuk do të dorëhiqet nga ky post, pasi që sipas tij, në rast se kjo ndodh “OSHP-në e merr lumi”.<sup>181</sup>

## Aktakuza tjetër për Hysni Hoxhën

Nga Gjykata Themelore e Prishtinës në janar 2015 u ngrit aktakuza ndaj drejtorit të KEK-

180 Artikulli “Kryetari i ‘Gjykatës’ së tenderëve në bankën e të akuzuarve”, gusht 2015 <http://kallxo.com/kryetari-i-gjykatës-se-tenderëve-ne-banken-e-te-akuzuarve/>

181 Artikulli “Hysni Hoxha: nuk jap dorëheqje”, dhjetor 2014 <http://kallxo.com/hysni-hoxha-nuk-jap-dorëheqje/>

ut Arben Gjukajt, kryetarit të Skenderajt Sami Lushtakut dhe 5 personave tjere për tenderin e sigurimit fizik të objektit të KEK-ut, vlera e të cilit ishte rreth 6 milion euro.

Në këtë rast gjyqësor Esat Tahiri dhe Milazim Lushtaku akuzohen për veprën penale mashtrim, ish-drejtori i Prokurimit Driton Pruthi, drejtori i KEK-ut Arben Gjukaj dhe ish-kryetari i OSHP-së Hysni Hoxha akuzohen për keqpërdorim të pozitës ose autoritetit zyrtar, ndërsa kryetari i Skënderajit, Sami Lushtaku, akuzohet për shtytje në keqpërdorim të detyrës zyrtare, kurse Azem Duraku akuzohet për nxitje në keqpërdorim.<sup>182</sup>

## Bllokimi dhe deblokimi i OSHP-së

Në janar 2016 Hysni Hoxha jep dorëheqje nga pozita si kryetarë i OSHP-së me arsyetimin se ishte lodhur duke pritur që OSHP-së t’i shtohen edhe dy anëtarët e bordit duke theksuar se dorëheqja e tij nuk kishte të bëjë me aktakuzat e ngritura.

“Unë kam qenë në pritje të vendimit të përzgjedhjes së dy anëtarëve të OSHP-së për më shumë se një vit, kjo nuk ka ndodhur, dhe si rezultat i kësaj rreth 50 ankesa kanë mbetur pa shqyrtuar ndërsa brenda këtyre ditëve kanë ardhur edhe disa të tjera të reja, dorëheqja nuk ka të bëjë me aktakuzat ndaj meje, ato janë gjepura edhe nuk ka lidhje me këtë, kjo ka të bëjë më shumë me lodhjen time,” pati deklaruar Hoxha për Gazetën JnK pas dorëheqjes.<sup>183</sup>

OSHP-ja kishte mbetur me dy anëtarë të bordit nga 5 sa duhet të ishin, funksioni i këtij institucioni mbeti e paralizuar në mungesë të emrimit të bordit të ri.<sup>184</sup>

182 Artikulli “Samir Lushtaku e Arben Gjukaj në gjyq për tenderin e KEK-ut”, shkurt 2016 <http://kallxo.com/sami-lushtaku-e-arben-gjukaj-ne-gjyq-per-tenderin-e-kek-ut/>

183 Artikulli “Ekskluzive: Flet ish shefi i tenderëve pas dorëheqjes”, janar 2016 <http://kallxo.com/ekskluzive-flet-ish-shefi-i-terndereve-pas-doreheqjes/>

184 Artikulli “Gjykata e Tenderëve Paralizohet nga Mungesa e Emërimeve”, mars 2016 <http://kallxo.com/gjnk/gjykata-e-tenderëve-paralizohet-nga-mungesa-e-emërimeve/>

Kompletimi dhe depolitizimi i OSHP-së u kërkua edhe nga Bashkimi Evropian si kriter për liberalizimin e vizave për Kosovën.<sup>185</sup>

Pas tri seancave të Kuvendit më në fund u zgjodh Kryetari dhe anëtarët e OSHP-së, Blerim Dina i cili në seancën e parë nuk i mori votat e duhura, në seancën e tretë u zgjodh Kryetarë i OSHP-së, si dhe u zgjodhën edhe dy anëtarët tjerë Nuhi Paqarizi dhe Goran Milenković.<sup>186</sup>

### Bajram Zogiani punonte nga burgu

Një anëtarë tjetër i OSHP-së Bajram Zogiani u shkarkua nga kjo pozitë në mars 2016, përderisa ky i fundit që nga dhjetori i vitit 2014 qëndronte në paraburgim, nën dyshimin për trafikim me çelëza.<sup>187</sup>

Bajram Zogiani edhe pse fizikisht nuk ishte në vendin e punës, ai për 14 muaj kishte vazhduar të marrë pagën si anëtarë i bordit të OSHP-së.

### Nexhat Krasniqi fajtorë për keqpërdorim me tender

Nexhat Krasniqi, Adem Zogiani, Safet Fazliu dhe Sadri Hykosmani në shtator 2015 u shpallën fajtorë për keqpërdorim të detyrës zyrtare nga një koleg gjykatësish në Gjykatën Themelore të Prishtinës.

Nexhat Krasniqi është dënuar me 12 muaj burg për keqpërdorim të detyrës zyrtare. Atij i është shqiptuar dënimi unik prej 26 muajsh burg.

Nexhat Krasniqi, ish-zyrtarët e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë për rastin në fjalë ngarkohej për marrje ryshfeti dhe hyrje në nënshkrimin e kontratave të dëmshme.

Zyrtarët tjerë të MTI-së u dënuan me burgim me kusht. Adem Zogiani me 10 muaj, Sadri Hykosmani me 8 muaj e Safet Fazliu me 7 muaj.<sup>188</sup>

Katër të akuzuarit u shpallën fajtorë për ndërtimin e "Parkut të Biznesit" në Drenas ku Nexhat Krasniqi si zyrtar në MTI kishte anashkaluar procedurat e prokurimit duke paguar kompaninë "Eltoni" avans 135 mijë euro për ndërtimin e parkut duke mos respektuar kushtet e kontratës.

Sadri Hykosmani e kishte aprovuar këtë pagesë si zyrtar i certifikues, Adem Zogiani nuk e kishte ndaluar pagesën përderisa Safet Fazliu nuk e kishte mbikëqyrur si duhet kontratën e nënshkruar.<sup>189</sup>

### Nexhat Krasniqi sërish në bankën e të akuzuarit

Mirëpo, për Nexhat Krasniqin, ish-zyrtarin e ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë akuzat nuk përfundojnë me atë vend pune. Pasi kishte kaluar në Ministri të Infrastrukturës si menaxher i prokurimit, ai po gjykohej së bashku me ish Ministrin e kësaj Ministrie Fatmir Limajn dhe zyrtarët tjerë, Endrit Shalën, Shpëtim Telakun si dhe pronarin e biznesit Florim Zukën. Ish-ministri Limaj dhe këta zyrtarë po gjykohen për korrupsion në prokurim publik për tenderin e mirëmbajtjes së rrugëve në regjionin e Gjilanit.<sup>190</sup>

185 Artikulli "Demarkacioni kusht për heqjen e vizave", dhjetor 2015 <http://kallxo.com/demarkacioni-kusht-per-heqjen-e-vizave/>

186 Artikulli "Blerim Dina në krye të OSHP-së", mars 2016 <http://kallxo.com/blerim-dina-ne-krye-te-oshp-se/>

187 Artikulli "Qeveria propozon shkarkimin e Bajram Zogianit", mars 2016 <http://kallxo.com/qeveria-propozon-shkarkimin-e-bajram-zogianit/>

188 Artikulli "Nexhat Krasniqi dënohet me 26 muaj burg", shtator 2015 <http://kallxo.com/nexhat-krasniqi-denohet-me-26-muaj-burg/>

189 Artikulli "Ja ku u gjetën fajtor Nexhat Krasniqi me shokë", shtator 2015 <http://kallxo.com/ja-ku-u-gjeten-fajtor-nexhat-krasniqi-me-shoke/>

190 Artikulli "Prokurori në rastin Limaj: Korrupsioni kancer që dëmton Kosovën", dhjetor 2015 <http://kallxo.com/prokurori-ne-rastin-limaj-korrupsioni-kancer-qe-demton-kosoven/>

## Denime të lehta për ish Minstrat e Kulturës

Një tjetër dënim u shqiptua gjatë vitit 2015 për dy ish-Ministra të Ministrisë së Kulturës Astrit Haraqia dhe Valton Beqiri për nënshkrimin e kontratave prej 570 mijë eurove në kundërshtim me Ligjin për Prokurim Publik dhe atë për Kinematografinë në vitin 2002-2008.

Astrit Haraqija e Valton Beqiri u dënuan me nga 10 muaj burg me kusht. Ata duhet të mos kryejnë vepra penale tjera në afatin prej dy vjetësh, nëse nuk duan të shkojnë në vuajtje të këtij dënimi, ndërsa producenti filmik Armond Morina u dënua me gjashtë muaj burg efektiv.<sup>191</sup>

Për ish Minstrat rasti nuk përfundoi këtu, Gjykata e Apeli ka vendosur që akgjykimi i shkallës së parë të anulohet dhe lënda ti kthehet Gjykatës Themelore në Prishtinë për rigjykim.

Apeli ka konstatuar gjithashtu që themeloria në dënimin ndaj ish-ministrave dhe producentëve “nuk përshkruan veprimet inkriminuese të të pandehurve dhe qëllimin e tyre për të kryer veprë penale”.<sup>192</sup>

## Keqpërdorime me barna

Një tjetër zyrtare prokurimi në një tjetër Ministri është duke u gjykuar për keqpërdorime me tender. Enkelejda Gjonbalaj nga Ministria e Shëndetësisë është akuzuar dhe është në proces gjyqësor për tenderin 1.1 milion euro për shkak të heqjes nga lista te barnave esenciale, barnat më të lira për të blerë ato më të shtrenjtat<sup>193</sup>

191 Artikulli “Dënimet me kusht për ish-Ministrat e Kulturës”, dhjetor 2015 <http://kallxo.com/denime-me-kusht-per-ish-ministrat-e-kultures/>

192 Artikulli “Kthehet në Rigjykim Rasti i Ish-Ministrave, qershorë 2016 <http://kallxo.com/kthehet-ne-rigjykim-rasti-ish-ministrave/>

193 Artikulli “Tenderi 1.1 milionësh i Ministrisë së Shëndetësisë në gjykatë”, shkurt 2016 <http://kallxo.com/tenderi-1-1-milionesh-i-ministrise-se-shendetesise-ne-gjykate/>

## Hedhen poshtë akuzat pas gjashtë viteve

Pas gjashtë vjetësh pasi kishte ndodhur rasti për të cilin akuzoheshin, Ekrem Maliqi, Berat Marmullaku, Bekim Fusha dhe Hajrullah Fejza nga Ministria e Shëndetësisë u shpallën të pafajshëm. Në aktakuzën e Prokurorisë Themelore të Prishtinës thuhej se gjatë vlerësimit të tenderit, furnizim me barna nga lista esenciale e Ministrisë së Shëndetësisë kanë rekomanduar si kompani fituese një kompani e cila nuk i ka plotësuar kriteret e tenderit, sepse ne dosjetë tenderit nuk ka dorëzuar autorizimin e prodhuesit -Zyra Regjionale Slloveni. Të gjitha pretendimet e prokurorisë, u hodhën poshtë, pasi trupi gjykues nuk gjeti prova kundër të akuzuarve.<sup>194</sup>

## Ndryshimet ligjore - shpresëdhënëse e frikësuese

Kuvendi i Republikës së Kosovës në një nga seancat që për lajm kishin gazin lotsjellës e protestat e kishte miratuar një nga ligjet më të rëndësishme- Ligjin e Prokurimit Publik.<sup>195</sup> Debati për këtë ligj ka munguar, ashtu si për shumë ligje të tjera të miratuara kryesisht në orët e vona. Për pasojë në ndryshimet e miratuara në ligjin e prokurimit ishin lëshuar dy gabime. Kuvendi ishte detyruar që t'i ndryshonte dy nene vetëm pas 2 muajve.<sup>196</sup> Miratimi i ndryshimeve të ligjit të prokurimit i kishte hapur rrugë reformës më të madhe në prokurimit publik që nga paslufta. E reforma më e madhe është thënë se do të jetë fillimi i aplikimit të prokurimit elektronik. Ligji kishte hyrë në fuqi me datën 29 dhjetor, ndërsa dy javë më vonë ishte përfunduar prokurimi elektronik. Gjashtë autoritetet kontraktuese në nivel qendrorë kanë nisur disa projekte përmes prokurimit elektronik.<sup>197</sup>

194 Artikulli “Të pafajshëm të akuzuarit për tenderin e barnave”, mars 2016 <http://kallxo.com/te-pafajshem-te-akuzuarit-per-tenderin-e-barnave-2/>

195 <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/05-L-068%20sh.pdf>

196 <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/05-L-092%20sh.pdf>

197 <http://kallxo.com/prokurimi-online-per-zvogelim-korrupsioni/>

Ishte planifikuar që prokurimi elektronik të nisë në muajin qershor në të gjitha autoritetet kontraktuese të nivelit qendror, por një gjë e tillë nuk pritët të ndodh. Tashmë, përmendet si mundësi muaji shtator, por nuk është zyrtare dhe mund të prolongohet edhe më shumë. Prokurimi elektronik nëpër AK lokale është paralajmëruar të startojë në janar të vitit 2017. Prokurimi Elektronik ka qenë një nga kushtet që BE-ja ia kishte vendosur Kosovës për liberalizim të vizave. Si platformë, që i heq letrat dhe mundësitë e ndërhyrjes nëpër dokumente, kjo formë e prokurimit është thënë se do t'i kursej deri në 10 për qind të buxhetit të shpenzuar përmes tenderëve.

Por, prokurimi elektronik nuk është ndryshimi i vetëm që ka ardhur nga ligji i amendamentuar i Prokurimit Publik. Disa nga ndryshimet e proklamuar nga qeveritarët është mundësia për ndarjen në lloje të tenderëve për t'ju mundësuar operatorëve ekonomike të vegjël që të marrin pjesë në projektet e qeverisë dhe komunave. Ky ndryshim bie ndesh me praktikën e Autoriteti Qendror të Prokurimit që ka centralizuar disa nga shërbimet duke dhënë vetëm një kontratë në emër të shumë institucioneve. Meqë ofrohet mundësia e ndarjes në lloje, AQP-ja duhet të ndajë në lloje tender të mëdhenj për të ju mundësuar më shumë kompanive të përfitojnë kontrata nga institucionet publike dhe të eliminojnë mundësinë e krijimit të monopole në fusha të caktuara.

Kur jemi të centralizimi, me ndryshimet ligjore është rritur numri i kompetencave të AQP-së pasi e njëjta tashmë me ligj është ngarkuar edhe me kryerjen e prokurimeve për institucionet e pavarura që i kanë më pak se 50 punëtor dhe që i përgjigjën Kuvendit apo qeverisë. Kjo e bënë të domosdoshme që të rritet numri i stafit në AQP. E përveç kësaj duhet të rritet edhe niveli i kontrollit të këtij institucioni dhe të caktohet saktë kompetencat e këtij institucioni dhe sidomos institucionin nën të cilin operon AQP-ja. Aktualisht është nën ministrin e Financave.

Gjithashtu me ligjin e ri organizatave joqeveritare u mundësohet që të marrin pjesë

nëpër tender publik. Por, është paraparë edhe detyrimi i kontraktorëve për të punësuar disa nga shtesat e shoqërisë që kanë më pak mundësi të gjejnë një vend pune në Kosovë si: të papunën për një kohë të gjatë, personat me aftësi të kufizuara, femrat etj. Ndryshim pozitiv është përcaktimi i qartë i përgjegjësisë individuale të secilit nga anëtarët e komisionit për vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve. Edhe kufizimi i përqindjes së ndryshimit të gabimeve aritmetikore është një nga ndryshimet e bëra në këtë ligj, që pritët të kufizojë dallaveret me gabimet e mundshme aritmetike. Tashmë, me ndryshimet ligjore që janë bërë është hequr kompetenca e marrjes së licencës së prokurimit nga OShP-ja dhe e njëjtat i është bartuar KRPP-së.

### Ndryshimi që ulë numrin e kompanive të papërgjegjshme

Nëse analizohen vendimet e OShP-së del që pjesa më e madhe e kompanive që shpallën të papërgjegjshme janë për shkak të mosdorëzimit të dokumenteve të kërkuara me dosjen e tenderit. Shumë operator pretendojnë se janë eliminuar padrejtësisht nga proceset e prokurimit me qëllim të favorizimit të ndonjë kompanie tjetër. Tashmë, me ndryshimet e bëra ligjore niveli i eliminimeve do të bie. Neni 72 i Ligjit bazikë lejon Autoritetet Kontraktuese që të ju mundësojnë operatorëve ekonomikë të plotësojnë ofertën e tyre. *“Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati të caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës”*<sup>198</sup>

198 Paragrafi I parë I nenit 72 të Ligjit të Prokurimit Publik.

## Legalizimi i tenderëve një-burimorë

Qeveria e Kosovës dhe Kuvendi janë kujdesur për të shlyer një nga nenet më të përfolura të ligjit të prokurimit në vitet e fundit. Një paragraf i nenit 34 që përcaktonte nevojën që për çdo tender të pranohen të paktën dy oferta të përgjegjshme është shlyrë tërësisht. Dikur, LPP-ja kërkonte që një tender të jetë i vlefshëm duhet të pranoheshin të paktën tri oferta të përgjegjshme. Bazuar në ligjin e kaluar, Autoritetet Kontraktuese janë obliguar të anulojnë një tender nëse kanë pranuar më pak se dy oferta të përgjegjshme. Shoqëria civile shpesh është thirr në këtë nen për të kundërshtuar projektet të mëdha.<sup>199</sup> Tashmë, me ligjin e ri nuk kërkohet që të pranohet 2 oferta të përgjegjshme. Kjo rrit rrezikun që AK të eliminojnë për një apo arsye të tjera operatorët e për të lënë në garë vetëm një nga ta, i cili shpallët fitues me automatizëm.

## Dy-shkallëshmëria e pasqaruar

Një nga ndryshimet e mëdha që janë bërë në fushën e prokurimit në vitin 2016 është edhe dy-shkallëshmëria e ankesave të operatorëve ekonomikë. Dy-shkallëshmëria e ankesave në proceset e prokurimit po bëhet për herë të parë në Kosovë. Deri më tani, operatorët janë ankuar vetëm në OSHP e cila ka lëshuar vendim të formës së prerë. I njëjtë është zbatuar nga Autoritetet Kontraktuese, mirëpo operatorëve ju është dhënë mundësia që të kërkojnë të drejtën e kompensimit në Gjykatën Themelore.

Tashmë, operatorët ekonomikë fillimisht duhet të dorëzojnë kërkesën për rishqyrtim tek Autoritetet Kontraktuese, që njihet si shkalla e parë.<sup>200</sup>

Por, kontestuese është mënyra e shqyrtimit të kërkesës së operatorëve, pasi në ligj nuk është

specifikuar nëse duhet të krijohen komisione të reja rivlerësuese apo kërkesa konsiderohet e shqyrtuar edhe nëse atë e bënë vetëm zyrtari kryesor financiar. Në “Rregullën e përparshtrim të ankesave” të publikuar në ueb-faqen e KRPP-së thuhet se shqyrtimin e ankesës e bënë Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit në kuadër të Autoritetit Kontraktues. Kjo rregull përcakton se në shkallën e parë, operatorët ekonomik kërkesën për rishqyrtim e parashtrajnë tek Autoriteti Kontraktues i cili udhëheq aktivitetin e prokurimit.

Kërkesën për rishqyrtim, operatorëve mund ta bëjnë në të gjitha fazat e prokurimit me kusht që të respektohen afatet kohore. Me paraqitjen e kërkesës për rishqyrtim, sipas rregullës së re, Autoritetet janë të obliguara të bëjnë pezullimin e aktivitetit të prokurimit deri në një vendim të ri të tyre.

Nëse operatorët nuk janë të kënaqur me përgjigjen e dhënë nga Autoriteti Kontraktues, ata mund të ankohen në OSHP. Por, me rregullën e re OSHP-ja nuk i shqyrton ankesat nëse operatori nuk e ka shfrytëzuar të drejtën për të kërkuar rishqyrtimin e vendimit tek Autoriteti Kontraktues.<sup>201</sup> Ankesë të jetë e kompletuar duhet të ketë të bashkangjitur një kopje të vendimit të miratuar nga autoriteti kontraktues gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të ligjit të Prokurimit Publik.

Përveç kësaj KRPP-ja ka bërë edhe një ndryshim tjetër substancial. E ka shtrenjtuar taksën për ankesën e bërë në OSHP. Nga 500 euro fikse sa është tash, pritet të bëhet deri në 5 mijë euro. Këto ndryshime janë pjesë e “Rregullave për parashtrim të ankesave”.

Dorëzimi i kërkesës për rishqyrtim në shkallën e parë, përkatësisht tek Autoritetit Kontraktues, është pa pagesë. Mirëpo, ankesa në shkallën e dytë, Organin Shqyrtues të Prokurimit, është me pagesë. Deri më tani tarifa e ankesës

199 <http://kallxo.com/kosid-i-kundershton-procesin-jotransparent-per-kosoven-e-re/>

200 <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/05-L-068%20sh.pdf>; Neni 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve.

201 Neni 9 dhe 10 I “Rregullave për parashtrim të ankesave” që është miratuar nga KRPP, e që ka hyrë në fuqi në fund të muajit mars.

në OSHP ka qenë fikse për gjitha llojet e tenderëve, por kjo pritet të ndryshojë.

Shuma e tarifës së ankesës është e barabartë me dy përqind (2%) të vlerës së ofertës, por jo më pak se 500 Euro dhe jo më shumë se 5,000 Euro. Pagesa do të bëhet me para të gatshme apo të barasvlershme në llogarinë e krijuar nga OSHP.<sup>202</sup>

Bazuar në këtë rregull të re, të gjitha ankesat që bëhen nga operatorët ekonomik që kanë dorëzuar një ofertë më të lartë se 250 mijë euro do të paguajnë tarifën maksimale prej 5 mijë euro. E njëjta shumë do të paguhet edhe nga operatorët që kanë dorëzuar oferta më të larta se 250 mijë euro. Po ashtu, për ofertat që janë prej 100 mijë euro, operatorët do të obligohen të paguajnë një tarifë prej 2 mijë euro.

Tarifa e ulët prej 500 euro do të paguajnë vetëm operatorët që kanë dorëzuar një ofertë që është 25 mijë apo më e ulët.

## Prokurimet elektronike

Ndryshimi më i madh që pritet të finalizohet këtë vit janë prokurimet elektronike. Meqë ende ka mungesa të informatave për pilot-projektet që janë nisur përmes kësaj forme të prokurimit publik nuk dihen ende të metat eventuale të tij. Por, ajo që tashmë dihet është nevoja për trajnimin e zyrtarëve të prokurimit, por edhe operatorëve ekonomik për të përdorë këtë formë të prokurimit. Si i tillë, prokurimi elektronik pritet të eliminojë mundësin e ndërhyrjes së personave në procesin e prokurimit. Por, luftimi i korrupsionit përmes kësaj forme është parë me skepticizëm<sup>203</sup>, ndoshta marr parasysh edhe faktin që disa nga shtetet që e kanë aplikuar vazhdojnë të përballen me telashet e korrupsionit.

Por, çfarë mund të thuhet deri më tani është vonesa në trajnimin e zyrtarëve të

prokurimit. Prokurimi elektronik në nivel qendror planifikohet të nis në muajin shtator dhe ende nuk janë bërë trajnimet. Sfiduese do të jetë trajnimi i të gjithë zyrtarëve, duke përfshirë edhe zyrtarët e nivelit lokal, deri në fund të këtij viti.

<sup>202</sup> Rregulla për parashtrim të ankesave. Neni 14, paragrafi I tretë

<sup>203</sup> <http://www.telegrafi.com/prokurimi-elektronik-nuk-eliminon-korrupsionin/>



# KONKLUZIONE

Prokurimi Publik apo vetë fjala “tender” në Kosovë pothuajse sinonim e ka fjalën “korrupsion”.

Prokurimi Publik ka lindur si nevojë për kursimin e buxhetit, ndërsa praktika dëshmon të kundërtën.

Shkeljet ligjore të prokurimit nisin që në fillim, me planifikimin e dobët të tij duke e dëmtuar jo vetëm buxhetin por imazhin e vendit në përgjithësi. Shkelje janë evidentuar edhe gjatë fazës së vlerësimit dhe krahasimit të ofertave. Praktika ka dëshmuar se shkelje ligjore ka bërë edhe OShP-ja, ajo që është kompetente për të vendosur drejtësin në prokurim. Pra, nga vendimet e OShP-së, por edhe të Gjykatave del që shkeljet ligjore nëpër tender ka në të gjitha hallkat institucionale.

Raportet e ndryshme vendore dhe ndërkombëtare në vazhdimësi japin kritika për fushën e prokurimit. Kjo gjendje vazhdon pa përmirësime dhe këtë e dëshmon edhe Zyra e Auditorit në fund të vitit me raportet e rregullsisë pasi në fushën e prokurimit gjen të gjitha llojet e shkeljeve të ligjit të prokurimit, për të cilat jep rekomandime e të cilat nuk adresohen fare.

Rastet e gjykuara për keqpërdorime me tenderë vazhdojnë të marrin dënime të lehta, të cilat nuk do të ndihmojnë në ngritjen e performancës së institucioneve në këtë fushë.

Po ashtu rastet nën hetime të keqpërdorimeve me tenderë të zyrtarëve të lartë, shumica rezultojnë me lirim nga akuzat në mungesë të provave dhe vonesave në hetime. Kjo çështje duhet të ngritet në nivel të Këshillit Prokurorial, për të parë nëse Prokuroret që merren me tenderomanin të specializohen dhe të kenë trajnime shtesë për këtë fushë.

Në institucione ende nuk merret seriozisht planifikimi i prokurimit, gjatë vitit shpenzohet

buxheti pa kurrfarë përgjegjësie duke blerë mallra pa kurrfarë procedure të prokurimit, si dhe me çmim më të shtrenjtë se vlera që kanë këto produkte në treg.

Menaxherët e zyrave të prokurimit janë bartës të një nga proceset më të rëndësishme në një institucion dhe si të tillë duhet të jenë të paanshëm dhe profesional për të garantuar që paraja e taksapaguesve do të shkojë në vendin e duhur. Si të tillë, ata janë edhe përgjegjësit kryesor para ligjit për të gjithë procesin e prokurimit.

Formimi i komisioneve vlerësuese të tenderëve brenda institucioneve ende vazhdon të jetë formal, duke mos qenë i përbërë nga persona adekuatë profesionistë siç e kërkon Ligji i Prokurimit.

KRPP gjatë vitit 2015 nuk ka lëvizur në raport me monitorimin e publikimit të kontratave, qëndron te monitorimi i kontratave të mëdha por në të shumtën e rasteve jo monitorim efektiv, duke i anashkaluar parregullsitë të cilat ndodhin në përshkrimin e specifikimeve në dosjet e tenderit.

Prokurimi elektronik është në fazën e pilotimit dhe kërkon përkushtim më të madh në evitimin e gabimeve, andaj Ministria e Financave duhet ta miratojë kërkesën e KRPP-së për plotësimin e stafit për këtë institucion.

OShP në disa raste nuk i shqyrton të gjitha pikat e ankesës, nuk vërteton dokumentacionet e falsifikuara me pretendimin se kjo i takon Autoritetit Kontraktues, nuk merret me çmimet jo-normalisht të ulëta apo të larta në dosjet e tenderit dhe në disa raste ka mospërputhje të raporteve të ekspertizave për rastet e njëjta.

Komisioni për legjislacion duhet sa më parë ta amandamentojë ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit që në nenin përkatës të shtojë përgjegjësitë e auditorit në marrjen

e masave ndëshkuese për institucionet të cilat vazhdimisht bëjnë shkelje të Ligjit të prokurimit.

Agjencia kundër Korrupsionit nuk bën përpjekje që ta forcojë departamentin për monitorimin e prokurimit publik, si dhe nuk bën përpjekje që opinionet e tyre të merren më seriozisht, e ato t'i adresojë te organet kompetente.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës duhet të funksionalizojë Gjykatën e Arbitrazhit, që rastet e gjykuara për keqpërdorime me tenderë të jenë të ndërmjetësuara edhe nga palët e treta në mënyrë që gjykimi të jetë i drejtë dhe i pa anshëm.

Politizimi dhe favorizimi në fushën e prokurimit ende vazhdon të jetë prezent në masë të madhe në institucionet buxhetore.

Në përfundime duhet të futet edhe nevoja për qartësimin e kompetencave të Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe institucioneve tjera. Pra, nëse AKK-ja konstaton që në një proces të prokurimit janë bërë shkelje ligjore dhe ato nuk merren parasysh, do të duhej që populli të ketë një përgjigje. A ka pasur të drejt AKK-ja, apo AK dhe OSHP-ja. Edhe dhënia e opinionëve të paqëndrueshme nga AKK do të duhej të ndëshkoheshin. Fundja edhe ata kanë dal nga e njëjta shoqëri dhe në ndonjë rast do të mund të përfshiheshin në afera korruptive për të kthyer në rivlerësim apo në ritenderim ndonjë procedurë të prokurimit.

# REKOMANDIMET

Përmes këtij raporti, jepen rekomandimet që do të duhej të adresoheshin nga të gjitha institucionet buxhetore, qofshin ato të nivelit qendror apo lokal, të cilat duhet ta marrin më seriozisht përmirësimin e prokurimit publik si një fushë të ndjeshme dhe mjaft e korruptuar. Rekomandimet në vijim i adresohen:

## Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës:

- Dobësitë e prokurimit elektronik të evitohen që në fazën e pilotimit;
- Të forcohen institucionet që merren me fushën e prokurimit me kapacitete profesionale njerëzore
- Komisionet përkatëse të kuvendit të jenë më funksionale gjatë monitorimit të punës së institucioneve që merren me prokurim publik;
- Të amandamentohet Ligji i Auditorit të Përgjithshëm me shtimin e kompetencave për marrjen e masave ndaj institucioneve që nuk i adresojnë rekomandimet;
- Ministria e Financave të jetë më bashkëpunuese me Agjencinë Qendrore të Prokurimit për zhvillimin e prokurimeve të centralizuara.

## Ministrisë së Drejtësisë

- Ta funksionalizojë gjykatën e arbitrazhit;
- Të ofrojë bashkëpunëtorë profesionalë të fushës së prokurimit për prokurorë dhe gjykatës;
- Të ndihmojë në specializimin e prokurorëve në fushën e prokurimit.

## Autoriteteve Kontraktuese

- Të jenë më të përgjegjshëm në shpenzimin e buxhetit përmes procedurave të prokurimit;
- Të bëjnë planifikim të mirëfilltë të shpenzimeve në fillim të vitit;

- T'i shmangen përshtatjes së specifikimeve në dosjen e tenderit për të favorizuar operatorë të caktuar ekonomikë
- Menaxherët e prokurimit të jenë të përgjegjshëm në aprovimin e kërkesave nga njësitë kërkuese për blerjen e produkteve
- Komisionet vlerësuese të tenderëve të caktohen sipas profesionalizmit dhe fushës së kërkuar;
- Të ndëshkohen operatorët ekonomikë nëse nuk i përmbahen planit dinamik duke ua ekzekutuar shumën e sigurimit të tenderit.

## KRPP-së

- Ta shtojë monitorimin e autoriteteve kontraktuese;
- Ta shtojë kontrollin e publikimit të njoftimeve të kontratave;
- T'i adresojë shkeljet ligjore të Autoriteteve Kontraktuese tek organet kompetente;
- Të japë rekomandime siç e kërkon Ligji i Prokurimit duke mos bërë dallime nga rasti në rast.

## OSHP-së

- Të bëjë ekspertiza më profesionale dhe të mos lejojë që raportet e ekspertizave të kenë kontradikta për rastet e njëjta
- Ta formojë departamentin e llogaritjeve të vlerave të kontratave që të parandalojë çmimet jo-normalisht të ulëta
- Të bëjë hetime më të thella si gjykatë e tenderëve.

## AQP-së

- Të bëjë prokurime të centralizuara për të gjitha llojet e shërbimeve specifike
- Të formojë dhe t'i publikojë listat me çmimet referente për të gjitha produktet.
- Për të ruajtur konkurrencën, të ndajë në lloje kontratat e mëdha sic është furnizimi me karburante etj.

RAPORTI I MONITORIMIT TË PROKURIMIT PUBLIK NË KOSOVË

# NDER ME TENDER

Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese - BIRN (Kosovë)

"Mensa e Studenteve" Kati i parë,  
Prishtinë 10000, Kosovë  
Website: [www.kosovo.birn.eu.com](http://www.kosovo.birn.eu.com)  
[www.internewskosova.org](http://www.internewskosova.org)  
Email: [kosova@birn.eu.com](mailto:kosova@birn.eu.com)  
[info@internewskosova.org](mailto:info@internewskosova.org)

Legjenda e fotografisë:

Fotografi e raportuar në [KALLXO.com](http://KALLXO.com) nga një qytetar nga Viti, ku shihen disa fidanë të mbjella në mes të rrugës, nëpër gropat të cilat nuk i kishte mbuluar askush. 11 shkurt 2015

Ky raport ka vënë në pah faktin se disa rrugë në gjendje të keqe në Kosovë janë ndërtuar nga kompani të cilat janë kualifikuar për kontrata publike vetëm për hir të lidhjeve politike apo familjare që kanë pasur me autoritetet publike që i kanë kontraktuar.

Dizjani nga:  
**project.GRAPHICS**